



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Departamenti për Integritim Evropian dhe Koordinim të Politikave
Divizioni për Koordinim të Politikave

Raport i Punës

së Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal
Janar-Dhjetor, 2017

Prishtinë, Dhjetor, 2017

Ky raport paraqet punën e MAPL-së për periudhën Janar-Dhjetor të vitit 2017. Raporti përmbledhë aktivitetet e të gjitha njësive organizative të MAPL-së duke u fokusuar në katër fusha kryesore, të cilat përbëjnë objektivat e punës së ministrisë sipas planit vjetor për vitin 2017.

Raporti është produkt i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal – MAPL i hartuar nga Departamenti për Integritim Evropian dhe Koordinim të Politikave - DIEKP

Përmbajtja

Shkurtesat	4
Hyrje	5
Përmbledhje ekzekutive	6
Objektivi 1	9
1. RRITJA E QËNDRUESHMËRISË EKONOMIKE DHE SOCIALE E KOMUNAVE PËR TË SIGURUAR QË POLITIKAT ZHVILLIMORE DHE FINANCIARE NDIKOJNË NË ZHVILLIMIN EKONOMIK LOKAL	9
Indeksi i arritjeve në fushën 1	9
Zhvillimi i kuadrit strategjik për zhvillim ekonomik lokal	9
Objektivi 2	15
2. ZHVILLIMI I KORNIZËS LIGJORE DHE ZBATIMI I LEGJISLACIONIT PËR VETËQEVERISJE LOKALE	15
Indeksi i arritjeve – objektivi 2	15
Objektivi 3	26
3. RRITJA E EFIKASITETIT DHE TRANSPARENCËS TË ADMINISTRATËS KOMUNALE NË OFRIMIN E SHËRBIMEVE PËR QYTETARË	26
Indeksi i arritjeve në fushën 3	25
Objektivi 4	32
FORCIMI I KAPACITETEVE PROFESIONALE DHE INSTITUCIONALE TË KOMUNAVE PËR TË PËRMBUSHUR KËRKESAT E QYTETARËVE DHE PËR TË ARRITUR PËRMIRËSIM TË QËNDRUESHËM NË SHËRBIMET KOMUNALE.....	32
Indeksi i arritjeve në fushën 4	32
Administrata dhe financat	367
Auditimi i brendshëm	39
Prokurimi	40

Shkurtesat

AKK	Asociacioni i Komunave të Kosovës
BE	Bashkimi Evropian
BNK	Bashkëpunimi Ndërkufitar
DEMOS	Decentralizimi dhe Mbështetja e Komunave
DIEKP	Departamenti për Integritet Evropian dhe Koordinim të Politikave
DIE	Divizioni për Integritet Evropian
DKP	Divizioni për Koordinim të Politikave
GIZ	Bashkëpunimi Gjerman për Zhvillim
IE	Integritet Evropian
IKAP	Instituti Kosovar për Administratë Publike
IPA	Integritet para anëtarësimit
KASH	Korniza Afatsmesme e Shpenzimeve
KCD	Koncept-dokument
KE	Komisioni Evropian
KEVL	Karta Evropiane për Vetëqeverisje Lokale
KCSF	Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MF	Ministria e Financave
MKRS	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
MSA	Marrëveshja e Stabilizimit Asociimit
NJDNJK	Njësi për Drejtat e Njeriut në Komuna
OB	Organizata Buxhetore
OSCE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian
PKZMSA	Plani Kombëtar për Zbatimin e MSA-së
RAE	Rom, ashkali dhe egjiptas
SVL	Strategjia për Vetëqeverisje Lokale 2016 – 2026
SMP	Sistemi për Menaxhimin e Performancës
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
USAID	Agjensioni për Zhvillim Ndërkombëtar
ZKM	Zyra e Kryeministrit

Hyrje

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) në përputhje me mandatin e saj ligjor, objektivat e Strategjisë për Vetëqeverisje Lokale 2016–2026, si dhe Planin Vjetor të Punës për vitin 2017, ka realizuar aktivitetet e planifikuara gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2017. Raporti në vijim pasqyron arritjet sipas fushave të përcaktuara, që njëherësh kanë qenë të integruara në Planin Vjetor të Punës së Qeverisë për vitin 2017. Katër objektivat e këtij plani që përbëjnë prioritetet për MAPL-në, janë:

- Rritja e qëndrueshmërisë ekonomike dhe sociale e komunave për të siguruar që politikat zhvillimore dhe financiare ndikojnë në zhvillimin ekonomik lokal;
- Zhvillimi i kornizës ligjore dhe zbatimi i legjislacionit për vetëqeverisje lokale;
- Rritja e efikasitetit dhe transparencës të administratës komunale në ofrimin e shërbimeve për qytetarë;
- Forcimi i kapaciteteve profesionale dhe institucionale të komunave për të përmbushur kërkesat e qytetarëve dhe për të arritur përmirësim të qëndrueshëm në shërbimet komunale.

Raporti bazohet në të dhënat periodike për aktivitetet e realizuara nga departamentet e MAPL-së, përkatësisht:

- Departamentit për Bashkëpunim dhe Zhvillim Rajonal;
- Departamentit për Integritet Evropian dhe Koordinim të Politikave;
- Departamentit Ligjor dhe për Monitorim të Komunave;
- Departamentit për Performancë dhe Transparencë në Komuna;
- Departamentit për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme;
- Divizioni për Komunikim dhe Informim;
- Divizioni i Auditimit të Brendshëm;
- Divizioni i Prokurimit.

Përmbledhje ekzekutive

Puna e departamenteve dhe njësive të MAPL-së gjatë periudhës njëvjeçare ka qenë mjaft produktive duke mundësuar realizimin e pjesës më të madhe të aktiviteteve sipas kornizës kohore të planifikuar. Për të siguruar zbatimin e objektivave strategjike të Ministrisë, të integruara në Planin e Punës së Qeverisë për vitin 2017, është bërë zbatim i aktiviteteve në Planin e detajuar të MAPL-së, i cili njëherësh përdoret edhe si instrument për kontrollimin e veprimeve dhe masave që duhet ndërmarrë nga njësitë përkatëse. Sipas këtij plani, raporti është ndarë në 4 objektiva kryesore dhe 23 fusha të zbatimit.

Gjatë kësaj periudhe raportuese, në kuadër të masave të ndërmarra për realizimin e *objektivit 1* të rritjes së qëndrueshmërisë ekonomike dhe sociale të komunave, janë hartuar dy koncept-dokumente, siç është: Koncept-Dokumenti për Zhvillim Ekonomik lokal (i aprovuar nga qeveria) dhe Koncept-Dokumenti për Zhvillim Rajonal. Bazuar në koncept-dokumentin e aprovuar, është hartuar Draft-Strategjia për zhvillim ekonomik lokal, e cila do të vazhdoj me fazat e tjera ligjore. Krahas hartimit të politikave, MAPL, përmes fondeve të investimeve kapitale, ka financuar 61 projekte kapitale për 37 komuna në vlerë 3,490,336.63 euro. Komunitat janë mbështetur edhe përmes financimit të projekteve në fushën e zhvillimit rajonal, si dhe aktiviteteve të tjera të ndërlidhura me Agjencionet për Zhvillim Rajonal. Njëkohësisht MAPL ka qenë e përfshirë në realizimin e projekteve nga programet e bashkëpunimit ndërkufitar: Kosovë-Shqipëri, Kosovë-Mal i Zi dhe Kosovë-Maqedoni.

Në kuadër të realizimit të *objektivit 2* të Planit të Punës që ndërlidhet me zhvillimin e kornizës ligjore dhe zbatimin e legjislacionit për vetëqeverisje lokale, të gjitha aktivitetet janë realizuar sipas afateve kohore të planifikuara. Në këtë drejtim, janë planifikuar të hartohen 5 Koncept-Dokumente, prej të cilave 2 janë aprovuar nga Qeveria, ndërsa 3 të tjera janë në proces të miratimit nga Qeveria. Gjithashtu, janë planifikuar të hartohen 2 projektligje, duke përfshirë: Projektligjin për Kryeqytetin e Republikës së Kosovës – Prishtinën, i cili është finalizuar dhe aprovuar nga Qeveria dhe ka kaluar shqyrtimin e parë në Kuvend, si dhe projektligjit për Kufijtë Administrativ të Komunave, ndryshimi i tij do të fillon pas aprovimit nga qeveria të Koncept-Dokumentit për Kufijtë Administrativ të Komunave. Në të njëjtën kohë janë finalizuar Projekt-Rregullorja për hartimin dhe publikimin e akteve komunale dhe Projekt-Rregullorja për sistemin e menaxhimit të performancës së shërbimeve komunale. Në këtë drejtim, MAPL ka ofruar mbështetjen edhe përmes identifikimit të projektligjeve që reflektojnë ndikim në sistemin për vetëqeverisje lokale, ku janë pranuar 107 akte ligjore, akte nënligjore, koncept dokumente, kod të mirësjelljes dhe memorandum. Në planin e vlerësimit të ndikimit të legjislacionit, MAPL ka bërë vlerësimin ex-post të ligjit për vetëqeverisje lokale dhe ka finalizuar një raport për këtë vlerësim.

Gjatë vitit 2017, nga gjithsej 464 mbledhje të mbajtura të kuvendeve të komunave janë monitoruar 452 prej tyre, për të cilat janë hartuar raportet individuale. MAPL ka pranuar gjithsej 572 akte për shqyrtim të ligjshmërisë, kurse 724 janë dërguar për vlerësim në ministritë e linjës. Në total, nga MAPL dhe ministritë e linjës janë evidentuar 69 shkelje ligjore me rastin e nxjerrjes së akteve nënligjore nga komunitat. Prej tyre, MAPL ka identifikuar 16 shkelje apo 2.79% nga totali i akteve të shqyrtuara, nga të cilat 6 janë harmonizuar konform kërkesës për rishqyrtim të ligjshmërisë, kurse 10 nuk janë harmonizuar. Nga Ministritë e linjës janë evidentuar 43 shkelje ligjore apo 5.66% nga totali i akteve të shqyrtuara, 12 prej të cilave janë rishqyrtuar dhe harmonizuar konform kërkesës për rishqyrtim, ndërsa 31 nuk janë harmonizuar. Të arriturat dhe sfidat e komunave sipas periudhave kohore janë pasqyruar përmes Raportit gjithëpërfshirës i punës së komunave për vitin 2016, i cili është dorëzuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës, si dhe dy raporteve të tjera tremujore të funksionimit të komunave për vitin 2017. Për të forcuar partneritetin me organet komunale në zbatimin e legjislacionit, janë mbajtur 6 takime me kryesues dhe

anëtarë të kuvendeve të komunave, si dhe takime të tjera me organizata joqeveritare për mbështetje të projekteve të përbashkëta për avancimin e vetëqeverisjes lokale në Kosovë.

Gjatë procesit të monitorimit të komunave në mënyrë të veçantë është kërkuar zbatimi i obligimeve që dalin nga agjenda evropiane, përkatësisht nga Programi Kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes për Stabilizim Asociim. Lidhur me këtë, është përgatitur matrica gjithëpërfshirëse për raportimin periodik të komunave, si dhe janë përgatitur planet individuale për 38 komuna për zbatimin e obligimeve nga agjenda evropiane për vitin 2017. Kësaj janë dërguar kërkesat për raportim në 38 komuna, për mbledhjen e të dhënave të zbatimit të këtyre obligimeve për periudhën Janar - Qershor 2017, si dhe është hartuar *Raporti i përgjithshëm i obligimeve nga agjenda evropiane për komuna*. Kurse, për periudhën janar – dhjetor, 2017 është dërguar kërkesa tek komunat për raportim lidhur me Përbushjen e Obligimeve të Agjendës Evropiane, ku komunat do të raportojnë deri në fund të vitit 2017. Gjithashtu, janë hartuar Raportet e MAPL-së për zbatimin e Programit Kombëtar për Zbatimin e MSA-së për periudhën Janar-Mars 2017, Janar-Qershor 2017, Janar-Shtator 2017, të cilat janë dërguar në MIE. Gjatë kësaj periudhe, MAPL ka ofruar të dhënat për Raportin e KE-së për Kosovën për periudhën 1 shtator 2016 – 30 shtator 2017. Krahas kësaj, MAPL ka bërë rishikimin e Matricës për PKZMSA 2018, si dhe ka vënë prioritetet e saja në kuadër të Agjendës për Reforma Evropiane për vitin 2018. Në kuadër të aktiviteteve në fushën e IE-së, është mbajtur edhe këshillimi i përbashkët me Zyrtarët Komunal për Integritet Evropiane dhe Asociacionin e Komunave të Kosovës me temën *“Roli i komunave në përbushjen e obligimeve nga agjenda evropiane”*.

Aktivitetet e realizuara në kuadër të *objektivit 3* që synojnë rritjen e efikasitetit dhe transparencës të administratës komunale në ofrimin e shërbimeve për qytetarë, janë grupuar në tri fusha kryesore përfshirë: 1) Vlerësimin e performancës në ofrimin e shërbimeve nga komunat; 2) Avancimin e sistemeve on-line të informacionit; dhe 3) Rritjen e transparencës. Gjatë përgatitjes së raportit për performancë komunale, janë realizuar vizita në të gjitha komunat për të verifikuar të dhënat e prezantuara lidhur me performancën komunale. Raporti i performancës komunale është publikuar në muajin qershor dhe në hap me këtë janë ndarë çmimet për 6 komunat me performancën më të mirë në ofrimin e shërbimeve për qytetarë.

Përveç kësaj, gjatë kësaj periudhe është zhvilluar programi elektronik për mbledhjen e të dhënave për performancë (SMP), si dhe është hartuar dokumenti kryesor i SMP-së. MAPL ka arritur bashkëpunimin me qeverinë zvicerane për jetësimin e skemës së granteve për komuna të bazuar në performancë, e cila do fillojë zbatohet në vitin 2018 me të cilën është planifikuar të ndahen 12 milion euro për 4 vite të ardhshme, për çka kemi vendosur edhe kriteret e veçanta të përfitimi. Po ashtu, është arritur të prezantohen ndryshimet e ueb-faqeve të komunave dhe finalizimi i propozimit për ueb-faqen e MAPL-së. Të arritura të tjera në këtë fushë janë: pranimi i pajisjeve për teleprezencë për komunat: Zubin Potok, Zvečan dhe Leposaviq, funksionalizimin e intranetit në të gjitha komunat, si dhe hartimin e projektit për menaxhimin e integruar të monitorimit dhe raportimit të MAPL-së (aktivitet i shpallur sipas procedurave të prokurimit publik). Është kontraktuar kompania fituese dhe aktualisht është në fazën e krijimit të sistemit për raportimin online. Po ashtu, është kontraktuar një kompani profesionale për programimin e Platformës së Monitorimit dhe Raportimit, sistem ky që përmbledh gjithsej 5 module specifike të menaxhimit të të dhënave: Modulin për raportim të zbatimit të Planeve të Punës së MAPL-së; Modulin për raportim javor të njëjësive të MAPL-së; Modulin për vlerësimin e ligjshmërisë së akteve komunale; Modulin për përcjelljen e zbatimit të rekomandimeve të auditorit; Modulin për monitorimin dhe raportimin e mbledhjeve të kuvendeve të komunave dhe komiteteve obligative, raportimeve të kryetarit të komunës, publikimit të akteve; tubimeve publike me qytetarë dhe takimeve të këshillave komunale për

siguri në bashkësi. Në hap me kryerjen e aktiviteteve në MAPL, informimi publik ka qenë njëra ndër prioritetet e punës së MAPL-së gjatë kësaj periudhe. Në këtë aspekt, janë publikuar 399 dokumente dhe informata në ueb-faqen e MAPL-së dhe është ofruar qasje në 12 dokumente zyrtare sipas kërkesës.

Treguesit e arritjeve në *objektivin 4* të Planit të punës (Forcimi i kapaciteteve profesionale dhe institucionale të komunave për të përmbushur kërkesat e qytetarëve dhe për të arritur përmirësim të qëndrueshëm në shërbimet komunale), janë grupuar në 3 fusha kryesore, duke përfshirë: 1) Ngritjen e kapaciteteve të zyrtarëve komunal; 2) Të drejtat e njeriut; 3) Bashkëpunimi me shoqërinë civile. Në këtë drejtim, MAPL ka hartuar planin e trajnimeve për komuna për vitin 2017, mbi bazën e së cilit janë realizuar 59 trajnime dhe janë trajnuar 1787 zyrtarë komunal. Janë fituar 2 projekte nga Komisioni Evropian në kuadër të instrumentit TAIEX, si dhe janë mbështetur 4 projekte të trajnimit për zyrtarët komunal nga donatorë të ndryshëm. Në kuadër të aktiviteteve për të drejtat e njeriut, ka vazhduar monitorimi i komunave në zbatimin e pakos ligjore për të drejtat e njeriut, si dhe është ofruar mbështetje në hartimin e dokumenteve strategjike të qeverisë në këtë fushë.

Sa i përket bashkëpunimit me shoqërinë civile, krahas aktiviteteve të shumta të përbashkëta me organizata joqeveritare dhe përfshirjes së tyre në grupet punuese, MAPL ka ndarë edhe fondin për financimin e projekteve për OJQ-të për të përmbushur një pjesë të obligimeve nga Strategjia për Vetëqeverisje Lokale 2016-2026. Kësisoj, gjatë kësaj periudhe janë financuar 46 projekte të organizatave joqeveritare në vlerë prej 173,326.00 euro.

MAPL, gjatë kësaj periudhe ka realizuar edhe aktivitetet e tjera të rregullta për menaxhimin e financave, administrimit të burimeve njerëzore, planin e prokurimit, si dhe planin e auditimit të brendshëm. Gjatë periudhës 12 mujore, totali i shpenzimeve për buxhetin e MAPL-së është në vlerën prej 4,196,207.36 EUR ose 84.91%, ndërsa prej kategorisë së donacionit është shpenzuar shuma prej 103,611.01 EUR ose 58.00 %.

Objektivi 1

1. RRRITJA E QËNDRUESHMËRISË EKONOMIKE DHE SOCIALE E KOMUNAVE PËR TË SIGURUAR QË POLITIKAT ZHVILLIMORE DHE FINANCIARE NDIKOJNË NË ZHVILLIMIN EKONOMIK LOKAL

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2017, MAPL ka vazhduar me realizimin e aktiviteteve të planifikuara në kuadër të objektivit 1 të Planit të Punës Qeverisë për vitin 2017, të cilat kanë për qëllim arritjen e prioriteteve strategjike të Ministrisë. Në kuadër të zbatimit të politikave me ndikim në zhvillimin ekonomik lokal, aktivitetet janë shtrirë përmes:

- Hartimit të politikave për zhvillim ekonomik lokal;
- Financimi i projekteve të komunave;
- Aktivitetet në zhvillimin rajonal;
- Bashkëpunimi ndërkomunal;
- Zbatimi i programeve të bashkëpunimit ndërkufitar.

Zhvillimi i kuadrit strategjik për zhvillim ekonomik lokal

Bazuar në objektivat e planit vjetor të punës së MAPL-së për vitin 2017, është hartuar dhe finalizuar *Koncept-Dokumenti për Zhvillim Ekonomik Lokal*. Qeveria ka aprovuar këtë koncept-dokument, mbi bazën e të cilit ka filluar procesi i hartimit të *Strategjisë për zhvillim ekonomik lokal*. Për këtë arsye, MAPL ka themeluar grupin punues ndërministror përgjegjës për hartimin e kësaj strategjie. Në vitin 2017, janë realizuar 2 takime të grupit punues, një punëtori dy ditore e grupit punues dhe 3 takime regionale, ku janë përfshirë zyrtarët e 38 komunave për të marrë propozimet e tyre lidhur me masat që duhet të adresohen përmes kësaj strategjisë. Grupi punues ka avancuar draftin e Strategjisë për zhvillim ekonomik lokal, ndërsa aktualisht drafti është duke u zhvilluar ende, para së të kalojë në fazat e tjera ligjore të: konsultimit paraprak, konsultimit publik, vlerësimit të ndikimit buxhetor dhe dërgimit për aprovim në Qeveri.

Po ashtu, gjatë kësaj periudhe MAPL ka marrë pjesë në forumin e liderëve lidhur me planifikimin e buxhetit në komuna organizuar nga MF dhe OSCE. Pjesëmarrja në grupin punues me MASHT-in dhe MF-në lidhur me hartimin e rregullores për planifikimin dhe shpenzimin e të hyrave vetanake të realizuara nga institucionet e arsimit dhe aftësisht profesional dhe arsimit për të rritur. Ky udhëzim ka hyrë në fuqi në muajin shkurt 2017 dhe ka pasur pjesëmarrje aktive në grupin punues të MAPL-së për konsultime paraprake, ku është dhënë kontribut i vazhdueshëm në fushën e financave lokale.

Indeksi i arritjeve në objektivin 1

- 2 koncept-dokumente të hartuara, (1 i aprovuar nga Qeveria)
- 6 Raporte/analiza të hartuara në fushën e financave lokale;
- * Një Konferencë për investimet kapitale;
- * 3 kërkesa janë evidentuar nga komunat në fushën e bashkëpunimit ndërkomunal dhe kanë marrë vlerësim ligjor nga MAPL;
- 61 projekte kapitale të financuara për 37 komuna në vlerë 3,490,336.63 euro;
- 46 projekte të financuara për OJQ në vlerë 173,326.00 euro;
- 1 doracak i hartuar për ciklin e menaxhimit të projekteve;
- 5 takime të mbajtura me AZHR-të;
- Kanë vazhduar të realizohen projektet nga programet e BNK-së: Kosovë - Shqipëri, Kosovë - Mal i Zi dhe Kosovë Maqedoni.

Projektet e financuara për komunat

61

projekte të komunave të
financuara, në vlerën prej
3,490,336.63

Financimi i projekteve të komunave

Gjatë kësaj periudhe, MAPL në kuadër planifikimeve buxhetore ka paraparë edhe financimin e projekteve kapitale të komunave, përmes së cilave është synuar ndikimi në zhvillimin ekonomik lokal. MAPL ka aplikuar 3 lloj formash për financimin e projekteve kapitale të komunave, si vijon:

- Projektet e financuara në bazë të thirrjes për propozime;
- Projekte të financuara për komunat jashtë skemës së thirrjes për propozime;
- Projekte të financuara nga granti stimulues për performancë komunale.

Me rastin e shpalljes së thirrjes për propozime, komunat kanë paraqitur 105 projekt-propozime për financim nga programi për projekte kapitale. Pas një procesi të shqyrtimit dhe vlerësimit të projekteve të komunave, komisioni vlerësues i MAPL-së ka përzgjedhur si të suksesshme 37 projekte të komunave, në kuadër të projekteve të pranuar jashtë skemës për thirrje janë pranuar 32 projekte dhe aprovuar 18. Ndërsa, në skemën e granteve për grantet stimulues janë aprovuar gjithsej 6 projekte. Në tërësi, gjatë vitit 2017 janë realizuar dhe implementuar 61 projekte në vlerën prej 3,490,336.63 euro. Në vijim është paraqitur skema e financimit të projekteve sipas dy formave të financimit:



Figura 1: Të dhënat për projektet kapitale të financuara nga MAPL për komunat.

Bashkëpunimi ndërkomunal

MAPL ka monitoruar aktivitetet e komunave në fushën e bashkëpunimit ndër-komunal. Përmes pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë në komuna është kërkuar qasje në të gjitha aktet e miratuara për bashkëpunim ndër-komunal dhe marrëveshjet e arritura të komunave brenda dhe jashtë vendit, duke shqyrtuar ligjshmërinë e vendimmarrjes konform dispozitave të Ligjit Nr.04/L-010 për bashkëpunim ndër-komunal. Po ashtu, para konfirmimit të marrëveshjes për binjakëzim, është dhënë vlerësimi i ligjshmërisë së tri iniciativave për binjakëzim - në mes të Komunës së Pejës dhe Komunës së Gucisë të Malit të Zi, - Gjilan- Viti, Pejë- Guci, Prizren – Amaysa.

Në kuadër të promovimit të politikave të bashkëpunimit ndër komunal, gjatë kësaj periudhe janë organizuar takimet me Agjencionet për Zhvillim Rajonal në komuna, për t'i koordinuar aktivitetet lidhur me bashkëpunimin ndërkomunal, binjakëzimin e komunave dhe organizimin e punëtorive regjionale me komunat. Është realizuar edhe takimi me Departamentin për Diplomaci Ekonomike në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Kosovës lidhur me koordinimin e aktiviteteve me misionet diplomatike në Kosovë. Në kuadër të koordinimit të aktiviteteve, në bashkëpunim me OSBE-në janë planifikuar gjashtë punëtori lidhur me BNK-të në vitin 2018, si dhe është mbajtur takimi me Ministrinë e Punëve të Jashtme të Kosovës për koordinimin e iniciativave për BNK. MAPL ka shqyrtuar 3 kërkesa nga komunat në fushën e bashkëpunimit ndër komunal, për të cilat është dhënë vlerësimi i ligjshmërisë. MAPL po ashtu, ka realizuar 6 vizita në komunat: Fushë Kosovë, Podujevë, Lipjan, Viti dhe Mamushë për të monitoruar aktivitetet në kuadër të iniciativave në fushën e bashkëpunimit ndër komunal. Në bashkëpunimin me organizatat që mbështesin qeverisjen lokale janë koordinuar aktivitetet për vitin 2018 me Misionin e OSBE-së në Kosovë për promovimin dhe nxitjen e iniciativave për bashkëpunim ndër komunal.

Zhvillimi rajonal

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2017, MAPL ka punuar në zhvillimin e Koncept-Dokumentit për Zhvillim Rajonal¹. Gjatë fazës së hartimit janë mbajtur një seri e takimeve me akterë të ndryshëm përfshirë, komunat, ministritë e linjës dhe organizatat e shoqërisë civile. Dokumenti është shqyrtuar në 2 takime konsultative me komunat dhe me OJQ-të. Po ashtu, më 7 korrik 2017, është mbajtur takimi i grupit punues dhe janë inkorporuar propozimet e adresuara nga ministritë e linjës. Veç kësaj, është realizuar vizita studimore në Slloveni dhe në Austri, në mënyrë që grupi punues të njihet më afër praktikave evropiane në fushën e zhvillimit rajonal. Gjatë procesit të hartimit të këtij koncept dokumenti ka pasur bashkëpunim të ngushtë me Zyrën e BE-së në Kosovë dhe Ministrinë e Integritimit Evropian, për të siguruar që dokumenti të plotësojë të gjitha kriteret e nevojshme për aprovim nga Qeveria. Njëherësh dokumenti ka kaluar procedurat e konsultimit publik dhe të konsultimit paraprak sipas nenit 7 të Rregullores për Punën e Qeverisë. Është bërë edhe vlerësimi i ndikimit buxhetor të këtij koncept-dokumenti, mirëpo duke marrë parasysh ndryshimet në strukturën e organeve të administratës shtetërore, përkatësisht krijimin e Ministrisë për Zhvillim Rajonal, kjo përgjegjësi do të bartet tek kjo e fundit për procedim të mëtejme.

¹ Ky KCD, tani është në përgjegjësi të Ministrisë për zhvillim rajonal

Sa i përket aktiviteteve të tjera në kuadër të zhvillimit rajonal, gjatë kësaj periudhe janë financuar projekte të shumta të komunave me ndikim në ekonominë lokale, të ndara nga fondet e MAPL-së, por edhe fondeve të BE-së të menaxhuara nga Agjencionet për Zhvillim Rajonal. Me qëllim të mbështetjes së projekteve për rigjenerimin ekonomik, krijimin e vendeve të punës dhe zhvillimin e burimeve njerëzore në rajonet ekonomike të Kosovës, është krijuar fondi i integruar për investime kapitale i lansuar nga MAPL, në të cilin janë përfshirë edhe projektet për zhvillim rajonal. Për të koordinuar aktivitetet me organizata përkatëse për zhvillim rajonal, MAPL ka hartuar planin e takimeve me 5 AZHR-të të cilat veprojnë në Kosovë me ç'rast nga ana e MAPL-së është bërë prezantimi i investimeve kapitale të komunave të ndara në rajone dhe të financuara nga MAPL-ja për vitet 2008-2016. Në këtë drejtim, janë mbajtur takime me AZHR-të, me të cilat janë diskutuar çështjet kuadrit strategjik të zhvillimit rajonal dhe format e mbështetjes së projekteve komunale në hapin e ardhshëm, si dhe është finalizuar tabela me numrin e institucioneve shkollore, numrit të nxënësve si dhe numrit të mësimit në komunat e Republikës së Kosovës për vitin 2015-2016.

Zbatimi i programeve të bashkëpunimit ndërkufitar

Gjatë kësaj periudhe (janar – dhjetor, 2017), MAPL ka hartuar tri analiza lidhur me mundësinë që Kosova të merr pjesë në bashkëpunimin transnacional, përkatësisht për programet: 1) Programi i bashkëpunimit transnacional DANUBI; 2) Programi i bashkëpunimit transnacional ADRION; 3) Programi i bashkëpunimit transnacional BALLKAN MEDITERIAN. Kurse, në kuadër të analizës për Programe transnacionale dhe iniciativave Rajonale është përfshirë edhe bashkëpunimi me Serbinë. Gjithashtu, MAPL ka shënuar progres edhe në kuadër të zbatimit të programeve për bashkëpunim ndërkufitar, përkatësisht në programet: Kosovë-Shqipëri, Kosovë-Mal i Zi dhe Kosovë-Maqedoni.

1) IPA I BNK Kosovë-Shqipëri 2010-2013

Në kuadër të Programit të Bashkëpunimit Ndërkufitar Kosovë – Shqipëri është duke u realizuar projekti strategjik *“Të ndërtojmë së bashku një rajon atraktiv dhe me prosperitet / Build Together an Attractive and Prosperous Region”*. Ky projekt nga ana e Kosovës përfshin ndërtimin dhe asfaltimin e rrugës ekzistuese nga fshati Krushevë deri në pikën kufitare në Shishtavec me gjatësi L=3.3 km, ndërtimin e parkingut afër pikës kufitare me sipërfaqe S=2000 m² instalimin e ndriçimit solar të parkingut dhe një pjesë e rrugës në hyrje të pikës kufitare si dhe furnizimi i pikës kufitare me energji elektrike ku përfshihet ndërtimi i linjës së tensionit të lartë dhe punimi i trafostacionit. Nga Zyra e BE-së në Kosovë, financohet 85% e projektit dhe përfshinë: ndërtimin dhe asfaltimin e rrugës ekzistuese nga fshati Krushevë deri në pikën kufitare në Shishtavec me gjatësi L=3.3 km dhe ndërtimin e parkingut afër pikës kufitare me sipërfaqe S=2000 m². Për realizimin e punimeve Zyra e BE-së në Kosovë, ka kontraktuar Kompaninë “RSM COMPANY sh.p.k”. Ndërsa, për përgatitjen e dizajnit final të projektit dhe mbikëqyrjen e punimeve është kontraktuar kompania “InfraPlus”. Nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) financohet 15% e projektit dhe përfshinë: instalimin e ndriçimit solar të parkingut dhe një pjesë e rrugës në hyrje të pikës kufitare, si dhe furnizimi i pikës kufitare me energji elektrike ku përfshihet ndërtimi i linjës së tensionit të lart dhe punimi i trafostacionit. Lidhur me realizimin e kësaj pjese të projektit, është nënshkruar Marrëveshja e Mirëkuptimit në mes MAPL-së dhe Komunës së Dragashit me datë 28.06.2016, me ç'rast janë ndarë

200,000.00 Euro. Më pas Komuna e Dragashit për realizimin e projektit ka kontraktuar kompaninë “Eling”, e cila është duke realizuar punimet në terren. Në këtë drejtim, punimet janë duke u realizuar në terren nga dy kompanitë e kontraktuara. MAPL ka monitoruar realizimin e punimeve sipas specifikave të projektit. Punimet janë në fazën finale dhe do të përfundojnë deri në fund të vitit 2017. Pjesa e projektit e financuar nga BE ka përfunduar në shkallën prej 75 %, kurse pjesa e financuar nga MAPL deri në 95%.

1) IPA II BNK Kosovë-Shqipëri 2014-2020

Në këtë program, thirrja publike për projekt-propozime është shpallur më datën 11 janar 2017 dhe ka qenë e hapur deri më datën 16 mars 2017, respektivisht 45 ditë. Më datat 13-14 shkurt 2017 është mbajtur trajnimi 2 ditorë në Lezhë/Shqipëri. Kurse, më datat 15-16 shkurt është mbajtur trajnimi 2 ditorë në Prizren/Kosovë, për aplikantët potencial. Veç kësaj, janë mbajtur 2 sesione informuese në Shqipëri (në Lezhë) më 1 shkurt 2017 dhe 2 shkurt në Kukës, si dhe dy sesione informuese në Kosovë, përkatësisht më 6 shkurt në Prizren dhe më 7 shkurt në Gjakovë. Ka filluar procesi i vlerësimit të projekteve të pranuar nga Thirrja e parë për projekt-propozime. Vlerësimi është duke u bërë nga delegacioni i BE-së në Tiranë. Si pjesë e këtij vlerësimi, MAPL ka marrë pjesë në cilësinë e vëzhguesit. Ka përfunduar procesi i vlerësimit të projekteve të pranuar nga Thirrja e parë për projekt-propozime. Vlerësimi është bërë nga delegacioni i BE-së në Tiranë. Nga Thirrja e parë për projekt-propozime, IPA II 2014 – 2020 kanë përfituar gjithsejtë 5 projekte dhe pritet kontraktimi mes përfituesve të projekteve dhe Autoritetit Kontraktues EUD/AL.

2) IPA I BNK Kosovë-Maqedoni 2010-2013

Lidhur me këtë program, ka përfunduar realizimi i të gjitha projekteve (6 projekte) nga fondet e IPA I. Sa i përket Projektit strategjik Shishtavec-Bellanovc i cili parasheh ndërtimin e pikës së përbashkët kufitare në mes të Maqedonisë dhe Kosovës, është hartuar dizajni final i projektit dhe është shpallur tenderi nga Zyra e BE-së në Kosovë. Është kontraktuar operatori për realizimin e punimeve, të cilat priten të fillojnë në momentin që dy shtetet, Kosova dhe Maqedonia do i përmbushin të gjitha obligimet sa i përket dokumentacionit dhe zotimeve të marra.

2) IPA II BNK Kosovë-Maqedoni 2014-2020

MAPL së bashku me Ministrinë e Qeverisjes Lokale të Maqedonisë dhe zyrën e BE-së në Kosovë kanë përgatitur Udhëzuesin për aplikantë me qëllim të informimit të palëve dhe caktimit të kriterëve për thirrjen për propozime. Thirrja publike për projekt propozime është shpallur më datën 13 qershor 2017 dhe do të jetë e hapur deri më datën 28 korrik 2017, respektivisht 45 ditë. Janë mbajtur 2 sesione informuese në Gjilan/Kosovë me datë 20 Qershor 2017 dhe Prizren/Kosovë me datë 21 Qershor 2017. Ka përfunduar procesi i vlerësimit të projekteve të pranuar nga Thirrja e parë për projekt-propozime. Vlerësimi është bërë nga Zyra e BE-së në Prishtinë. Kurse, nga thirrja e parë për projekt-propozime, IPA II 2014 – 2020 pritet kontraktimi mes përfituesve të projekteve dhe Autoritetit Kontraktues, zyra e BE-së në Kosovë.

3) IPA I BNK Kosovë-Mali i Zi 2011-2013

Sa i përket këtij programi, ka përfunduar implementimin 9 projektet e financuara nga Komisioni Evropian në vlerë të përgjithshme që kap shumën 3.2 milion euro.

3) IPA II BNK Kosovë-Mali i Zi 2014-2020

Ministria e Financave e Malit të zi, në cilësinë e autoritetit kontraktues në bashkëpunim me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal të Republikës së Kosovës, ka hapur thirrjen publike për projekt propozime, të shpallur më datën 10 mars 2017. Afati i thirrjes ka vlejtur deri më datën 26 prill 2017, respektivisht 45 ditë. Në datat 28 shkurt - 2 mars është mbajtur trajnimi 3 ditorë në Rozhajë/Mal të Zi, si dhe më datat 7 deri 9 mars është mbajtur trajnimi 3 ditor në Pejë/Kosovë. Janë organizuar dy fushata informuese ditore dhe forume për kërkimin e partnerëve (aplikantët potencial nga Kosova dhe Mali i Zi) për aplikim të përbashkët në projektet nga fondi i thirrjes. Ky aktivitet është realizuar më 27 shkurt 2017 në Rozhajë/Mal i zi dhe më 6 mars 2017 në Pejë/Kosovë. Gjithashtu, janë organizuar dhe mbajtur 2 sesione tjera informuese për aplikantët potencial në Mal të zi më 20 mars 2017, në Podgoricë në Bjelo Polje më 21 mars 2017, më 22 mars në Gjakovë/Kosovë dhe më 23 mars 2017 në Pejë Kosovë. Thirrja për projekt propozime është mbyllur me datën 26 prill 2017. Aktualisht, ka filluar procesi i vlerësimit nga Komiteti i Përbashkët Vlerësues pjesë e së cilit janë edhe dy zyrtarë të MAPL-së, si dhe pritet kontraktimi i projekteve nga IPA II 2014 – 2020 mes përfituesve të projekteve dhe Autoritetit Kontraktues, zyra e BE-së në Mal të Zi.

Hartimi i dokumenteve, raporteve, analizave, pjesëmarrja në grupet punuese

Me qëllim të mbështetjes së komunave në fushën e planifikimit buxhetor dhe menaxhimit financiar, përkatësisht sigurimin e resurseve shtese financiare dhe rritjen e inkasimit të të hyrave vetanake, janë bërë planifikimet me Ministrinë e Financave për realizimin e një punëtorie të përbashkët me komunat. Në kuadër të grupit punues me MASHT dhe MF-në, MAPL ka qenë e përfshirë në hartimin e Rregullores për planifikimin dhe shpenzimin e të hyrave vetanake të realizuara nga institucionet e arsimit dhe aftësisimit profesional dhe arsimit për të rritur. MAPL gjatë kësaj periudhe ka përgatitur raportet/dokumentet si në vijim:

- Dy dokumente lidhur me rekomandimet për Komisionin e Granteve një dokument me datën 07 mars 2017 dhe dokumenti tjetër më datën 30 mars 2017
- Raportin vjetor për të hyrat vetanake në muajin mars 2017;
- Raportin vjetor të shpenzimeve komunale në muajin mars 2017;
- Raportin lidhur me rekomandimet e auditorit të përgjithshëm për komuna në muajin gusht 2017;
- Analizën për investime kapitale të komunave sipas rajoneve për vitin 2016;
- Është finalizuar dhe publikuar analiza për investime kapitale;
- Raportin për investimet kapitale në komuna për arsim shëndetësi dhe administratë sipas burimeve të financimit për vitin 2017;
- Doracakun për ciklin e menaxhimit të projekteve, i shpërndarë në komuna.

- Dy dokumente lidhur me rekomandimet për Komisionin e Granteve;
- Raportin lidhur me planifikimin dhe gjendjen aktuale të stafit në komunat: Mitrovice Veriore, Zubin Potok, Zveçan dhe Laposaviq;
- Raport lidhur me planifikimin dhe gjendjen aktuale të stafit në komunat Mitrovicë Veriore, Zubin Potok, Zveçan dhe Laposaviq, gjithashtu është përgatitë informata lidhur me stafin dhe buxhetin në kategorinë e pagave për vitin 2017 për komunat Mitrovicë Veriore, Zubin Potok, Zveçan dhe Laposaviq. Është përgatitur raporti i Investimeve kapitale në komuna për arsim shëndetësi dhe administratë sipas burimeve të financimit për vitin 2017;
- Është përgatit raporti i buxheteve komunale për arsim shëndetësi dhe administratë sipas burimeve të financimit për vitin 2017;
- Raportin për buxhetin në kategorinë e pagave për vitin 2017 për komunat: Mitrovice Veriore, Zubin Potok, Zveçan dhe Laposaviq;
- Është realizuar konferenca në shtator 2017 lidhur me investimet kapitale në komuna për periudhën 2011-2016.

Indeksi i arritjeve – objektivi 2

- 5 koncept-dokumente të hartuara, prej të cilave 2 janë aprovuar nga Qeveria;
- 2 projekte të aprovuara nga TAEX;
- Aprovimi i projektligjit për Prishtinën në Qeveri;
- Vlerësimi ex-post i LVL-së dhe finalizimi i raportit për këtë vlerësim;
- 2 projekt-rregullore të ndryshuara dhe të finalizuara;
- 31 projektligje të identifikuar nga programi i Qeverisë që reflektojnë në sistemin e VQL-së;
- 107 akte ligjore dhe nënligjore të shqyrtuara në konsultim paraprak, prej të cilave 11 janë kthyer me vërejtje/komente;
- 6 takime regjionale të mbajtura me kryesues dhe anëtarë të kuvendeve të komunave;
- 1296 akte të pranuar nga komunat për vlerësim të ligjshmërisë;
- 572 akte të vlerësuara nga MAPL;
- 724 akte të proceduara për vlerësim në ministritë e linjës;
- 16 shkelje të evidentuara nga MAPL;
- 43 shkelje të evidentuara nga ministritë e linjës;
- 12 akte të kundërligjshme të rishqyrtuara dhe të harmonizuara nga komunat sipas kërkesës për rishqyrtim të MAPL-së;
- 31 akte të pa harmonizuara nga komunat (edhe pas kërkesës për rishqyrtim nga ministritë e linjës);
- 4 raporte të funksionimit të komunave të hartuara;
- 5 Raporte të hartuara në fushën e integritimeve evropiane;
- 1 Raport gjithëpërfshirës i punës së komunave i dorëzuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës;
- 2 Plane të punës të hartuara;
- 1 Plan indikativ i hartuar për vitin 2018;
- 1 Plan i integruar për zbatimin e rekomandimeve të auditorit të brendshëm dhe të jashtëm, i hartuar;
- 4 analiza të zbatimit të planit të punës së MAPL-së të hartuara.

Objektivi 2

2. ZHVILLIMI I KORNIZËS LIGJORE DHE ZBATIMI I LEGJISLACIONIT PËR VETËQEVERISJE LOKALE

Aktivitetet e realizuara gjatë kësaj periudhe që ndërlidhen me përmbushjen e objektivit 2 të Planit të Punës për vitin 2017, janë shtrirë në drejtim të:

- Zhvillimit të koncept-dokumenteve;
- Hartimit të projekt-ligjeve dhe akteve nënligjore të planifikuara;
- Konsultimit paraprak të akteve sektoriale;
- Vlerësimit ex-post të Ligjit për vetëqeverisje lokale;
- Takimeve të rregullta me komunat;
- Monitorimit të komunave;
- Adresimin dhe zbatimin e obligimeve nga agjenda evropiane;
- Raporteve të hartuara;
- Koordinimit të politikave.

Zhvillimi i Koncept-dokumenteve

Në kuadër të detyrave të planifikuara për periudhën Janar-Dhjetor 2017, në fushën e zhvillimit të kornizës

ligjore për vetëqeverisje lokale, MAPL ka planifikuar 5 koncept-dokumente, përkatësisht:

- Koncept-dokumentin për Zhvillim Ekonomik Lokal²;
- Koncept-dokumentin për Zhvillim Rajonal
- Koncept-Dokumentin për Kufijtë Administrativ të Komunave³;
- Koncept-Dokumentin për Akademinë për Vetëqeverisje Lokale;
- Koncept-dokumenti për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës.

1) *Koncept-dokumenti për Zhvillim ekonomik lokal* – është aprovuar nga Qeveria.

2) *Koncept Dokumenti për Zhvillim Rajonal* – i ka kaluar të gjitha fazat e hartimit. Tani është bartur si përgjegjësi e ministrisë për zhvillim rajonal.

3) *Koncept-dokumenti për kufijtë administrativ të komunave* - Me qëllim të përgatitjes për ndryshimin dhe plotësimin e kornizës ligjore për kufijtë administrativ të komunave, është nxjerrë Vendimi Nr.02-185/4 dt.14.10.2016 për themelimin e Grupit punues për hartimin e Koncept-Dokumentit për kufijtë administrativ të komunave. Gjatë kësaj periudhe, grupi punues ka përgatitur draftin e parë të këtij koncept-dokumentit. Veç kësaj, është konfirmuar mbështetja nga Komisionin Evropian përmes instrumentit mbështetës TAIEX sipas projektit të paraqitur, në bazë të cilit ekspertët nga BE është mbajtur trajnimi i cili kishte për qëllim prezantimin e parimeve themelore dhe modelin sloven për krijimin dhe përcaktimin e territorit të komunave. Trajnimi është mbajtur nga një ekspert sloven, i cili ka ofruar mbështetje në dhënien e orientimeve për hartimin e koncept-dokumentit në fjalë, duke marrë për bazë praktikat më të mira slovene dhe të BE-së në përgjithësi. Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe është mbajtur edhe trajnimi me ekspertin nga TAIEX-i për finalizimin e koncept dokumentit për kufijtë administrative të komunave. Drafti është finalizuar, është përkthyer në dy gjuhë nga grupi punues, si dhe është dërguar për procedim tutje.

3) *Koncept-dokumenti për Akademinë për VQL* - Gjatë periudhës janar – dhjetor, 2017 MAPL ka mbajtur një takim me grupin ndër ministror për hartimin e *Koncept-Dokumentit për Akademinë për Vetëqeverisje Lokale*. Koncept-Dokumenti është finalizuar nga grupi punues dhe është përgatitur kostoja financiare e implementimit. Më tutje, përmes instrumentit TAIEX të Komisionit Evropian janë angazhuar dy ekspertë nga ky program për mbajtjen e trajnimit dy ditor për grupin punues ndërministror për hartimin e koncept dokumentit për Akademinë për Vetëqeverisje Lokale. Angazhimi i tyre ka ardhur si rezultat i aplikimit me projektin “*Ndërtimi i kapaciteteve për qeverisjen lokale*”. Koncept-Dokumenti për Akademinë për Vetëqeverisje Lokale për një afat 30 ditor është publikuar në faqen zyrtare të MAPL për konsultime **paraprake** dhe në Platformën e Qeverisë për Konsultime Publike. Gjatë këtij procesi janë dhënë komente nga subjekte të ndryshme si: Zyra Ligjore e ZKM-së, Zyra për Planifikim Strategjik, Sekretariati Koordinues i

² Elaboruar më gjerësisht në kuadër të Objektivit 1

³ Po aty

Qeverisë, Ministria e Administratës Publike, IKAP-i, Asociacioni i Komunave të Kosovës, SIDA dhe OSBE. Pas këtij stadi të konsultimeve publike, kanë vazhduar procedurat e konsultimit paraprak konform nenit 7 të Rregullores së Punës së Qeverisë Nr. 09/2011 me ç'rast kanë përfunduar procedurat në fjalë. KD për Akademinë për VQL është në fazën e përgatitjes për procedim në Qeveri për aprovim.

Koncept-dokumenti për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës është finalizuar, dorëzuar në qeveri dhe është aprovuar nga Qeveria. Më poshtë është paraqitur figura për ecurinë e zhvillimit të koncept-dokumenteve të planifikuara:

Mbështetja në politikat sektoriale

Derisa kanë vazhduar punët rreth hartimit të dokumenteve strategjike për të cilat organ propozues ka qenë MAPL, aktivitetet janë shtrirë edhe në hartimin e politikave sektoriale në kuadër të grupeve punuese ndërministrorë, si dhe përmes dhënies së komenteve në dokumentet e ministrive të linjës. Në këtë drejtim, duhet nënvizuar përgatitja e propozimeve për hartimin dokumenteve si vijon:

- Koncept-Dokumentin për çështjen e suspendimit nga marrëdhënia e punës të zyrtarëve publik nga institucionet e Republikës së Kosovës, e iniciuar nga Ministria e Drejtësisë
- Propozimet në Draft-Strategjinë Kundër Korrupsion, si dhe janë kostuar dhe buxhetuar masat/veprimet e saj në Planin e Veprimit Kundër Korrupsion 2018-2022.
- Propozimet në Draft-Strategjinë Kundër Terrorizmit 2017-2021.
- Angazhimi në grupin punues për hartimin e Koncept-dokumentit për reformën e inspekcioneve.

Zhvillimi i akteve ligjore dhe nënligjore

Sa u përket projektligjeve të planifikuara, në kuadër të programit legjislativ të Qeverisë është paraparë edhe hartimi i *Projektligjit për Kryeqytetin e Republikës së Kosovës – Prishtinën dhe Projektligjit për kufijtë administrativ të komunave*.

Projektligji për Kryeqytetin e Republikës së Kosovës/Prishtinën – MAPL ka përmbyllur procesin e hartimit të projektligjit për Prishtinën, të cilin e ka proceduar në Qeveri. Gjatë zhvillimit të këtij projektligji janë ndërmarrë një mori veprimesh duke përfshirë: takimet e rregullta të grupit punues, konsultimet shtesë me Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Ministrinë për Shëndetësi për të marrë opinionin e tyre lidhur me kompetencat e kryeqytetit në fushën e sigurisë dhe kujdesit dytësor shëndetësor, konsultimi njëditor në mes të juristëve të MAPL-së dhe Grupit Punues, procedurat e konsultimit publik dhe konsultimi paraprak. Gjatë periudhës një vjeçare është hartuar raporti për konsultime publike dhe paraprake, në të cilën janë përfshirë komentet e inkuorporuara, raporti është publikuar në platformën on-line. Pas kësaj procedure, Projektligji për Kryeqytetin e Republikës së Kosovës/Prishtinën është miratuar në Qeveri dhe ka kaluar shqyrtimin e parë në Kuvend.

Projektligji për kufijtë administrativ të komunave – ky aktivitet është pezulluar deri në hartimin e koncept-dokumentit për kufijtë administrativ të komunave dhe aprovimin nga Qeveria.

Projektligji për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës – lidhur me këtë projektligj, gjatë periudhës janar – dhjetor, 2017 është hartuar vendimi për formimin e grupit punues. Grupi punues ka finalizuar draftin fillestar të projektligjit, ka mbajtur 8 takime të brendshme dhe 2 takime ndërministrorë me ministritë e linjës të përfshira në këtë projektligj. Përmbajtja e projektligjit është përafëruar me orientimet e koncept-dokumentit të miratuar në Qeveri me datë 7 prill të këtij viti. Janë mbajtur punëtori dyditore me grupin punues, drejtorë për çështje pronësore dhe OJQ, punëtori këto të cilat janë organizuar në bashkëpunim me projektin e USAID-it për finalizimin e projektligjit. Projektligji ka kaluar fazën e konsultimit publik dhe paraprak. Ndërsa, me datë 24 nëntor është mbajtur një takim publik me komuna dhe OJQ, ku grupi punues ka diskutuar për komentet të cilat kanë ardhur gjatë fazës së konsultimit. Janë inkorporuar komentet dhe është hartuar Raporti për konsultim publik ku janë përfshi të gjitha komentet dhe arsyetimet e tyre, si dhe është finalizuar drafti i projektligjit. Pastaj, janë hartuar shkresat për MF deklarata financiare dhe për MIE deklarata e përputhshmërisë me legjislacionin e BE-se, si dhe janë proceduar më tej.

Hartimi i akteve nënligjore

Në kuadër të fushës së zhvillimit të legjislacionit, MAPL ka realizuar edhe aktivitete të tjera, si vijon:

- MAPL miratuar *Rregulloren (MAPL) Nr.01/2017 për hartimin dhe publikim e akteve të komunës*. Janë zhvilluar të gjitha proceset për plotësimin e kësaj rregullore, duke përfshirë takimet me komunat, zhvillimin e procesit të konsultimit publik, konsultimit paraprak dhe fazat e tjera procedurale. Rregullorja është finalizuar më 23 gusht 2017 dhe është nënshkruar nga Ministri i MAPL-së. Kjo rregullore është dërguar në ZKM, është përfshirë në regjistrin e akteve nënligjore të MAPL-së dhe është publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.
- Është themeluar grupi punues për hartimin e *Projekt-rregulloren Nr.02/2013 për sistemin e menaxhimit të performancës së shërbimeve komunale*. Janë mbajtur 5 takime për draftimin e kësaj rregulloreje. Janë marrë të gjitha komentet nga palët e interesit, duke përfshirë: komunat dhe organizatat e huaja të cilat mbështesin këtë proces. Rregullorja ka kaluar fazën e konsultimit paraprak dhe atë publik.

Identifikimi dhe hartimi i listës së projektligjeve që ndërlidhen me vetëqeverisjen lokale

Bazuar në Programin Legjislativ të Qeverisë për vitin 2017, MAPL ka identifikuar 31 projektligje nga ky program, të cilat ndërlidhen me kompetencat dhe organizimin e vetëqeverisjes lokale, si dhe mandatin e MAPL-së. Përmes shkresës informuese të dërguar në ZKM, është kërkuar që të gjitha projektligjet që ndërlidhen me vetëqeverisjen lokale të dërgohen për konsultim paraprak në MAPL për tu harmonizuar me legjislacionin bazë të vetëqeverisjes lokale.

Vlerësimi i ndikimit të politikave në fushën e vetëqeverisjes lokale

Me qëllim përmirësimin e politikave në drejtim të thellimit të demokracisë vendore, ka përfunduar procesi i vlerësimit të ndikimit të zbatimit të Ligjit për Vetëqeverisje lokale - ex-post. Grupi punues ka

mbajtur 3 takime dhe ka identifikuar dispozitat ligjore të cilat duhet të jenë pjesë e ndryshimeve. Në kuadër të vlerësimit të ndikimit të këtij ligji, që nga koha e aprovimit janë konsultuar një numër i madh i dokumenteve, analizave dhe vlerësimeve të mëparshme të ligjit për vetëqeverisje lokale. Gjithashtu, për të siguruar përmirësimin e teknikave të vlerësimit ex-post, anëtarët e grupit punues kanë marrë pjesë në trajnimin e organizuar nga Zyra e Kryeministrit për metodologjinë dhe procedurat e vlerësimit ex-post, si dhe është raporti final për vlerësimin ex-post të këtij ligji.

Takimet me zyrtarët komunal

Për nevoja të identifikimit të problemeve në sistemin e vetëqeverisjes lokale janë zhvilluar 6 takime regjionale me kryesues të kuvendeve të komunave dhe anëtarë të kuvendeve të komunave. Gjatë këtyre takimeve, janë **evidentuar** të gjitha propozimet lidhur me nevojat për ndryshimin e legjislacionit për vetëqeverisje lokale, të cilat mund të shërbejnë gjatë hartimit të politikave dhe vlerësimit ex-post të LVL-së. Duke marrë parasysh ofrimin e datës së zgjedhjeve lokale, në kuadër të këtyre takimeve janë prezantuar obligimet e komunave para dhe pas zgjedhjeve lokale të vitit 2017.

Konsultimi paraprak i akteve sektoriale

Sa i përket konsultimit paraprak të akteve të ministrive sektoriale dhe përputhshmërisë së tyre me legjislacionin për vetëqeverisje lokale, gjatë kësaj periudhe (**janar – dhjetor, 2017**) janë pranuar për konsultim gjithsej: 107 akte ligjore, akte nënligjore, koncept dokumente, kod të mirësjelljes dhe memorandum, prej të cilave:

- Njëzet e katër (24) projektligje;
- Njëzet e pesë (25) Projekt-rregullore;
- Katër dhjetë e një (41) Udhëzime Administrative;
- Pesëmbëdhjetë (15) Koncept-dokumente;
- Një (1) Kod të mirësjelljes për FSK-në;
- Një (1) Memorandumi mbi regjimin e tregtisë së jashtme.

107

akte sektoriale të vlerësuara
nga aspekti i përputhshmërisë
me legjislacionin për
vetëqeverisje lokale



Figura: 3 Vlerësimi i përputhshmërisë së akteve sektoriale me legjislacionin për VQL.

Prej akteve të shqyrtuara në konsultim paraprak, 96 janë konstatuar se janë në përputhje me legjislacionin bazë për vetëqeverisje lokale, ndërsa janë dhënë komente për 11 akte të tjera, si vijon:

- Projektligjin për tatimin në pronën e paluajtshme, iniciuar nga MF;
- Projektligji për zjarrfikje dhe shpëtim, iniciuar nga MPB;
- Projekt-Udhëzimi Administrativ për themelimin, financimin dhe operimin e zyrave komunale të energjisë, iniciuar nga MZHE;
- Projekt-Udhëzimi Administrativ programin, mënyrën e aftësisë dhe veprimet e njësive shkollore të trafikut, rrobat dhe emblemat, iniciuar nga MPB;
- Projekt-Udhëzim Administrativ për plotësimin dhe ndryshimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 10/2012 për organizimin, fushëveprimin dhe funksionimin e këshillit për shërbime sociale dhe familjare, iniciuar nga MPMS;
- Projekt-Udhëzim Administrativ për strukturën e pagesave të ujit, iniciuar nga MMPH;
- Projekt- rregullore për procedurat e rekrutimit në shërbimin civil, iniciuar nga MAP;
- Projekt-Rregulloren mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit të OJQ-ve, MF;
- Projekt-Rregulloren për riintegrimin e personave të riatdhesuar dhe menaxhimin e programit të riintegrimit, iniciuar nga MPB;
- Memorandumi mbi regjimin e tregtisë së jashtme, iniciuar nga MTI;
- Koncept dokumenti për suspendimin dhe largimin nga puna të zyrtarëve publik, iniciuar nga MD.

Sa i përket harmonizimit të legjislacionit për vetëqeverisje lokale me atë të BE-së, gjatë kësaj periudhe nuk ka pasur ndonjë akt ligjor për dhënien e opinionit për sa i përket përmbushjes së standardeve evropiane.

Monitorimi i kuvendeve të komunave

Bazuar në mandatin e ministritsë, edhe në këtë periudhë një vjeçare ka vazhduar monitorimi i kuvendeve të komunave, i fokusuar në *monitorimin elektronik si dhe monitorimin me pjesëmarrje*. Andaj, gjatë vitit 2017, MAPL përmes mekanizmave të mbikëqyrjes së punës së komunave ka monitoruar 452 mbledhje të mbajtura të kuvendeve të komunave, nga 464 sa janë mbajtur gjithsej. Nga ministritë e linjës janë evidentuar 41 shkelje ligjore apo 5.66% nga totali i akteve të shqyrtuara, 12 prej të cilave janë rishqyrtuar dhe harmonizuar konform kërkesës për rishqyrtim, ndërsa 31 nuk janë harmonizuar ende.



Monitorimi është realizuar edhe përmes pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë të monitoruesve në komuna, ku në bazë të planit gjithëpërfshirës të monitorimit në këtë formë janë monitoruar 17 komuna. Para miratimit të akteve komunale, MAPL ka ofruar mbështetje ligjore për komunat edhe përmes *konsultimit paraprak*. Gjatë periudhës në fjalë, komunat kanë parashtruar 5 kërkesa për konsultime paraprake me rastin e aprovimit të akteve komunale, për të cilat MAPL ka ofruar udhëzimet përkatëse ligjore.




Figura 4: Monitorimi i mbledhjeve të kuvendeve të komunave dhe shqyrtimi i ligjshmërisë së akteve komunale.

Lidhur me vlerësimin e ligjshmërisë së akteve komunale, gjatë vitit 2017 MAPL ka shqyrtuar ligjshmërinë e 572 akte të komunave, kurse 724 akte të tjera janë dërguar për vlerësim në ministritë e linjës. Në total, janë evidentuar 69 shkelje ligjore. Prej tyre, MAPL ka identifikuar 16 shkelje apo 2.79%, nga të cilat 6 janë harmonizuar konform kërkesës për rishqyrtim të ligjshmërisë, kurse 10 komuna të tjera nuk i kanë harmonizuar si vijon: Graçanicë (1), Glllogoc (1), Dragash (2), Deçan (1) Istog (3), Klllokot (2).

Nga Ministritë e linjës janë evidentuar 43 shkelje ligjore apo 5.66% nga totali i akteve të shqyrtuara, 12 prej të cilave janë rishqyrtuar dhe harmonizuar konform kërkesës për rishqyrtim, ndërsa 31 nuk janë

harmonizuar. Komunitat të cilat nuk i kanë rishqyrtuar aktet e kundërligjshme janë: Ferizaj (5), Viti (1), Suharekë (2), Rahovec (1), Shtime (1), Gjilan (2), Fushë Kosovë (2), Prizren (1), Istog (4), Prishtinë (5), Glllogoc (1), Deçan (1), Skenderaj (1), Malishevë (2), Vushtrri (1), Podujevë (1).

Para miratimit të akteve komunale, MAPL ka ofruar mbështetje ligjore për komunitat edhe përmes konsultimit paraprak. Gjatë periudhës në fjalë, komunitat kanë parashtruar 5 kërkesa për konsultime paraprake me rastin e aprovimit të akteve komunale, për të cilat MAPL ka ofruar udhëzimet përkatëse ligjore. Përveç kësaj, janë pranuar dhe shqyrtuar 17 kërkesa dhe 19 ankesa nga persona fizikë dhe juridik, për të cilët janë ofruar përgjigjet brenda afatit ligjor. Monitorimi është shtrirë edhe përmes pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë të monitoruesve në komuna. Në bazë të planit gjithëpërfshirës të monitorimit gjatë kësaj periudhe janë monitoruar 17 komuna. Për të gjitha rastet e monitoruara janë hartuar raportet e monitorimit të cilat evidentojnë shkallën e arritshmërisë së komunave në çështjet e zbatimit të obligimeve të tyre ligjore.

Monitorimi i zbatimit të obligimeve para dhe pas zgjedhjeve lokale

MAPL ka punuar ngushtë me strukturat komunale dhe partnerë të tjerë për koordinimin e veprimeve në funksion të përmbushjes së obligimeve para dhe pas zgjedhjeve lokale. Duke marrë parasysh përgatitjet për zgjedhjet lokale të këtij viti, MAPL ne bashkëpunim me OSBE-në kanë mbajtur 7 takime me 38 komuna për të sqaruar të gjitha obligimet e të zgjedhurve lokale para dhe pas procesit zgjedhor. Pas certifikimit të rezultateve zgjedhore, MAPL ka monitoruar të 30 mbledhje inauguruese të Kuvendeve të Komunave, me qëllim të sigurimit që i gjithë procesi është zbatuar konform legjislacionit në fuqi.

Monitorimi i mbledhjeve të tjera do të vazhdoj sipas agjendës së planifikuar të komunave. Në këtë proces, MAPL ka monitoruar procesin e dhënies së betimit nga anëtarët kuvendeve dhe kryetarët e zgjedhur. I gjithë procesi është vlerësuar të jetë në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm.

100%

të akteve janë vlerësuar nga aspekti i ligjshmërisë nga MAPL sipas kompetencës.

72%

E akteve të kundërligjshme të evidentuara nga MAPL për të cilat ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim, janë harmonizuar nga Komunitat.

27%

E akteve të kundërligjshme të evidentuara nga ministritë e linjës për të cilat janë paraqitur kërkesat për rishqyrtim janë harmonizuar nga komunitat.

Mbështetja dhe monitorimi i komunave për adresimin dhe zbatimin e obligimeve nga agjenda evropiane

Sa i përket përmbushjes së obligimeve nga agjenda evropiane, gjatë kësaj periudhe është përgatitur matrica gjithëpërfshirëse për raportimin periodik të komunave. Në kuadër të aktiviteteve në këtë fushë, është mbajtur edhe këshillimi i përbashkët 3 ditorë me Zyrtarët Komunal për Integritim Evropian dhe Asociacionin e Komunave të Kosovës, përkrahur nga projekti DEMOS/Helvetas – Swiss Intercoopertaion Kosovo, me temën “Roli i komunave në përmbushjen e obligimeve nga agjenda evropiane”.



Në këtë takim janë ofruar udhëzimet për formën e re të raportimit sipas obligimeve që dalin nga agjenda evropiane. Janë përgatitur planet individuale për 38 komuna nga obligimet e agjendës evropiane për vitin 2017 dhe janë hartuar raportet e veçanta për secilën komunë. Është dërguar kërkesa për raportim në komuna për periudhën Janar - Qershor 2017, si dhe është hartuar *Raporti i përgjithshëm i obligimeve nga agjenda evropiane për komuna për këtë periudhë*. Mbi bazën e këtij raporti është finalizuar analiza për shkallën e përmbushjes së obligimeve të komunave nga agjenda evropiane për periudhën Janar-Qershor 2017, si dhe analiza e përmbushjes së obligimeve të MAPL-së nga agjenda evropiane për periudhën Janar–Qershor 2017

Lidhur me shkallën e përmbushjes së obligimeve nga agjenda evropiane, në vitin 2017 komunat kanë arritur të përmbushin 71% të aktiviteteve të parapara në fushën e kriterëve politike, 70% të aktiviteteve të parapara në kuadër të kriterëve ekonomike, ndërsa në fushën e standardeve evropiane kanë realizuar 68% të aktiviteteve. Niveli i përgjithshëm i përmbushjes së kriterëve nga agjenda evropiane ka qenë 69.66%. Andaj, me qëllim të adresimit të obligimeve për zbatimin e detyrave të mbetura nga agjenda evropiane, janë realizuar 16 vizita monitoruese në komuna për të riafirmuar rëndësinë e përmbushjes së obligimeve të komunave në këtë proces, si dhe për të adresuar individualisht obligimet e mbetura të komunave në këtë proces.

Kurse, për periudhën janar – dhjetor, 2017 është dërguar kërkesa tek komunat për raportim lidhur me Përmbushjen e Obligimeve të Agjendës Evropiane, ku komunat do të raportojnë deri në fund të vitit 2017, pastaj mbi bazën e këtij raporti do të finalizohet raporti vjetor (janar – dhjetor, 2017) për nga obligimet e agjendën evropiane.

Gjithashtu, janë hartuar Raportet e MAPL-së për zbatimin e Programit Kombëtar për Zbatimin e MSA-së për periudhën Janar-Mars 2017, Janar-Qershor 2017, Janar-Shtator 2017, të cilat janë dërguar në MIE. Gjatë kësaj periudhe, MAPL ka ofruar të dhënat për Raportin e KE-së për Kosovën për periudhën 1 shtator 2016 – 30 shtator 2017. Krahas kësaj, MAPL ka bërë rishikimin e Matricës për PKZMSA 2018, si dhe ka vënë prioritetet e saja në kuadër të Agjendës për Reforma Evropiane për vitin 2018, si dhe është përditësuar raporti përmbledhës për takimin e Këshillimit të Stailizim Asociimit Kosovë – BE.

Sa i përket koordinimi të aktiviteteve të MAPL-së për projekt-propozimet për IPA, MAPL ka përgatitur listën e prioriteteve të identifikuar të MAPL-së, në planifikimin e programeve IPA 2018 – 2020, në kuadër

të Dokumentit Planifikues Sektorial (DPS) “*Konkurreshmëria dhe Inovacioni*”, më saktësisht nën-sektori për Turizëm dhe Zhvillim Ekonomik Lokal, si dhe sa i përket projekteve të financuara nga Komisioni Evropian, në kuadër të fondeve të IPA Shumë-Përfituese për vitin 2018, është bërë identifikimi i sektorëve që ndërlidhen me MAPL-në.

MAPL ka mbajtur takime të ndryshme me MIE-në, Kolegjiun për integritet Evropian, institucionet e tjera qeveritare, joqeveritare, si dhe institucionet ndërkombëtare, donatorët dhe zyrtarët për integritet evropian. Po ashtu janë përgatitur prezantime, informata, si dhe është shënuar një numër i konsiderueshëm i pjesëmarrjeve në konferenca, komisione dhe grupe të ndryshme punuese, brenda dhe jashtë ministrisë.

Aktivitetet në numra dhe në përqindje



Raportet e hartuara dhe të publikuara

Me qëllim të pasqyrit të aktiviteteve të zhvilluara nga kuvendet e komunave është hartuar dhe publikuar *Raporti i funksionimit të kuvendeve të komunave për periudhën Prill-Qershor 2017*. Gjithashtu, është hartuar dhe dorëzuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës *Raporti i funksionimit të komunave Janar-Dhjetor 2016*. Në bashkëpunim me USAID-in është organizuar ngjarja për prezantimin e të arriturave dhe sfidave të komunave, në praninë e kryetarëve të komunave, kryesuesve të kuvendeve të komunave, përfaqësuesve të shoqërisë civile, asociacionit të komunave dhe mediave.

Koordinimi i politikave

MAPL ka koordinuar aktivitetet brenda dhe jashtë saj. Fillimisht është koordinuar procesi rreth hartimit të planit vjetor të punës për Qeveri dhe planit vjetor të punës për MAPL-së. Veç kësaj është hartuar Planin indikativ të punës për vitin 2018, i cili është i ndërlidhur me hartimin e dokumentit të KASH-it për vitin 2018-2020, si dhe është bërë identifikimi i aktiviteteve për vitin 2018 nga Plani i Veprimit të Strategjisë për Vetëqeverisje Lokale 2016-2026. Gjithashtu, është koordinuar procesi i hartimit të raportit Janar-Qershor 2017, prill-qershor 2017, korrik – shtator, 2017 dhe tetor – dhjetor, 2017 të punës për MAPL-së për Qeveri, si dhe tri raporteve për zbatimin e vendimeve të Qeverisë. Po ashtu, me qëllim të pasqyrës së më të mirë të raporteve të MAPL-së në baza periodike janë hartuar analiza për cilësinë e raportimit. Njëkohësisht janë hartuar edhe raportet narrative të punës së MAPL-së në baza periodike. Një numër i madh i aktiviteteve të zhvilluara janë bërë në bashkëpunim të ngushtë me partnerët dhe donatorët e

tjerë, si: OSBE, DEMOS, UNDP, BB, GIZ, USAID, etj, me qëllim të avancimit të vetëqeverisjes lokale në Kosovë.

Për të pasqyruar performancën e njësive organizative të MAPL-së, është hartuar analiza e realizimit të planit të punës së MAPL-së për vitin 2016, analiza e zbatimit të planit të punës Janar-Qershor 2017 dhe Janar-Shtator, 2017, si dhe është në proces të hartimit analiza e zbatimit për periudhën Janar-Dhjetor, 2017. Kurse, me qëllim të prezantimit të aktiviteteve kryesore të njësive në MAPL, është përgatitur fleta informuese e Ministrisë për vitin 2016 e cila është dërguar për publikim në faqen zyrtare të MAPL-së, si dhe është finalizuar draft dokumenti për përfshirjen e qytetarëve në punët vullnetare në nivel lokal.

MAPL ka hartuar Udhëzuesin për obligimet e komunave para dhe pas procesit zgjedhor, është bërë edhe bashkëndimi i aktiviteteve me grupin ndërministror për hartimin e Koncept Dokumentit për Akademinë për Vetëqeverisje Lokale për mbajtjen e takimeve në vitin 2017 dhe është lansuar koncept dokumenti në faqen zyrtare të MAPL-së për konsultime publike për një afat 30 ditor është publikuar në faqen zyrtare të MAPL për konsultime publike dhe në Platformën e Qeverisë për Konsultime Publike. Gjatë këtij procesi janë dhënë komente nga subjekte të ndryshme si: Zyra Ligjore e ZKM-së, Zyra për Planifikim Strategjik, Sekretariati Koordinues i Qeverisë, Ministria e Administratës Publike, IKAP-i, Asociacioni i Komunave të Kosovës, SIDA dhe OSBE.

Zbatimi i rekomandimeve të auditorit

Gjatë kësaj periudhe (janar – dhjetor, 2017) është hartuar plani i integruar për zbatimin e rekomandimeve të auditorit të brendshëm dhe të jashtëm, i cili është duke u monitoruar në vazhdimësi. Ky plan përmban aktivitetet që duhet të ndërmerren për zbatimin e rekomandimeve të dhëna, si dhe kohën e realizimit të tyre nga njësitet e MAPL-së. Janë hartuar raportet periodike për zbatimin e rekomandimeve të auditorit, raportet periodike për listën e vetë vlerësimit, si dhe raportet periodike për listën e rreziqeve.

Indeksi i arritjeve në objektivin 3

- Realizimi i vizitave në të gjitha komunat për verifikimin e të dhënave për performancë komunale;
- Përgatitja e databazës elektronike (SIMFK);
- Publikimi i raportit të performancës komunale për vitin 2016;
- Ndarja e çmimeve për 6 komuna për performancën më të mirë;
- Zhvillimi i programit elektronik për mbledhjen e të dhënave për performancë (SMPK);
- Hartimi i dokumentit kryesor të SMPK-së
- Përgatitja e dokumentit për metodologjitë standard për matjen e kënaqshmërisë së qytetarëve për shërbimet e ofruara nga komunat;
- Finalizimi i propozimeve për ueb-faqet e komunave;
- Finalizimi i propozimit për ueb-faqen e MAPL-së;
- Blerja e pajisjeve të Teleprezencës për Komunitet: Zubin Potok, Zveçan dhe Leposaviq;
- Funksionalizimi i intranetit në të gjitha komunat;
- Hartimi i projektit për menaxhimin e integruar të të dhënave të MAPL-së (Sistemi i integruar i raportimit);
- Publikimi i 399 dokumenteve dhe informatave në ueb-faqen e MAPL-së;
- Ofrimi i qasjes në 12 dokumente zyrtare sipas kërkesës;
- Monitorimi i transparencës komunale dhe hartimi i raporteve sinas fushave

Objektivi 3

3. Rritja e efikasitetit dhe transparencës të administratës komunale në ofrimin e shërbimeve për qytetarë

Në kuadër të objektivit 3 për rritjen e efikasitetit dhe transparencës së administratës komunale, zhvillimi i aktiviteteve është fokusuar në:

- Vlerësimin e performancës në ofrimin e shërbimeve nga komunat;
- Avancimin e sistemeve on-line të informacionit;
- Transparencën.

Vlerësimi i performancës komunale

Gjatë periudhës raportuese Janar – Dhjetor 2017, MAPL ka bërë vlerësimin e performancës së komunave në ofrimin e shërbimeve me qytetarë. Monitorimi i performancës komunale është bërë përmes metodologjisë standarde për mbledhjen, verifikimin dhe raportimin e të dhënave komunale. Me qëllim të verifikimit të të dhënave dhe ofrimit të udhëzimeve për raportim, janë bërë vizita në komuna dhe është monitoruar mbledhja e të dhënave për vitin 2016. Gjatë këtyre vizitave, janë ofruar këshilla për të gjitha njësitë komunale të performancës për procesin e mbledhjes dhe verifikimit të të dhënave.

Veç kësaj, është përgatitur databaza elektronike (SIMFK), në të cilën janë sistemuar të gjitha të dhënat e raportuara nga komunat. Po ashtu, është bërë përpunimi i të dhënave komunale dhe sistemimi i tyre në databazën finale të SMPK-së. Gjatë kësaj periudhe është publikuar raporti i performancës së komunave për vitin 2016. Njëherësh, komunat janë informuar për kriteret e ndarjes së granteve stimuluese për performancë. Bazuar në performancën e treguar në ofrimin e shërbimeve për qytetarë, janë ndarë shpërblimet nga granti stimulues për 6 komunat më të suksesshme, sipas renditjes: Junik, Shtime, Prizren, Istog, Drenas dhe Prishtinë. Ndryshe nga to, komunat të cilat nuk kanë raportuar janë: Zubin Potok, Zveçan, Leposaviq dhe Mitrovicë Veriore.

Në këtë periudhë, është bërë edhe testimi i programit elektronik të mbledhjes së të dhënave për performancë komunale (SMP). Gjithashtu, MAPL ka arritur bashkëpunimin me qeverinë zvicerane për jetësimin e skemës së granteve për komuna të bazuar në performancë, e cila do fillojë zbatohet në vitin 2018 me të cilën është planifikuar të ndahen 12 milion euro për 4 vite të ardhshme, për çka kemi vendosur edhe kriteret e veçanta të përfitimit. Rimodelimi i sistemit elektronik të menaxhimit të të dhënave është vlerësuar të jetë i suksesshëm, mirëpo ende nuk është vendosur në funksion. Pas lansimit të këtij programi, të gjitha të dhënat për performancë komunale do jenë të qasshme në formë elektronike. Përveç kësaj, është hartuar Dokumenti kryesor i SMP-së i cili shtjellon rëndësinë e matjes së performancës, përgjegjësitë e

6

*Komuna kanë
përfituar fonde
sipas performancës
në ofrimin e
shërbimeve për
qytetarë*

përdoruesve të sistemit, parimet e funksionimit, mënyrën e operimit të sistemit dhe formula e kualifikimit të komunave sipas performancës.

Po ashtu, është bërë përgatitja e dokumentit të metodologjisë standarde për matjen e kënaqshmërisë së qytetarëve me shërbimet e ofruara komunale, si dhe është hartuar Rregullorja për SMPK-së. Është përfunduar plani i trajnimeve për aftësimin e zyrtarëve komunal për zbatimin e SMPK- së ku MAPL në bashkëpunim me institutin për Administratë Publike në Kosovë ka bërë të gjitha përgatitjet për zhvillimin e trajnimeve në lidhje me zbatimin e sistemin për menaxhimin e performancës komunale nga ana e komunave. Certifikimi i zyrtarëve komunal është bartur për vitin 2018. Kjo do të bëhet nga IKAP në bashkëpunim me MAPL- në. Certifikimi do të bëhet në bazë të rezultateve të trajnimeve dhe në bazë të raportimit të të dhënave komunale për performancë.

MAPL ka mbajtur takimin e rregullt me koordinatorët e komunave për Performancën komunale. Në takim kanë marrë pjesë shumica e koordinatorëve të komunave, qëllimi i takimit ka qenë dhënia e udhëzimeve të nevojshme për raportimin e të dhënave për vitin 2017 në sistemin për menaxhimin e performancës komunale.

Avancimi i sistemeve on-line të informacionit

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2017, MAPL ka shënuar progres në fushën e përmirësimit të sistemeve online të informacionit dhe transparencën me qytetarë. Përmes projektit DEMOS, është kontraktuar kompania përgjegjëse (Cactus) për zhvillimin e faqeve zyrtare elektronike të komunave, sistemin e teleprezencës për monitorim të kuvendeve të komunave, si dhe ri-dizajnimin e faqes zyrtare elektronike të MAPL-së. Për nevoja të procesit në fjalë, është themeluar Grupi mbështetës për hartimin e përmbajtjes së faqes zyrtare elektronike të MAPL-së, krijimin e profilit zyrtar të MAPL-së në rrjetin social facebook, si dhe ofrimin e propozimeve shtesë për finalizimin e faqeve zyrtare elektronike të komunave. Grupi ka finalizuar projekt-propozimin për ueb-faqen e MAPL-së dhe profilin zyrtar në facebook përmes së cilit është duke lansuar informata të ndryshme mbi realizimin e aktiviteteve ditore të MAPL-së, si dhe ka propozuar platformën e komunikimit për çështjet e sigurisë në bashkësi, e cila do të jetë pjesë e ueb-faqeve zyrtare të komunave. Gjithashtu, është propozuar edhe platforma për komunikim publik me qytetarë, e cila do mundësoj parashtrimin e pyetjeve online nga qytetarët dhe njëkohësisht marrjen e përgjigjeve përmes platformës së veçantë të integruar në ueb-faqen e MAPL-së. Nga kjo kompani është bërë prezantimi i parë i përmbajtjes së ueb-faqeve të komunave dhe MAPL-së. Ueb-faqet e ri-modeluara janë në fazën e testimit dhe pritet të vihen në funksion në fillim të muajit korrik kur edhe do të bëhet migrimi i shënimeve.

Gjatë vitit 2017, është bërë mbikëqyrja e implementimit të projektit Solucione të IT-së për Komuna ku janë funksionalizuar komponentët si në vijim: 1. Intraneti është plotësisht funksional; 2. Gjurmimi i lejeve të ndërtimit është dizajnuar dhe ka filluar të zhvillohet pritet të vihet në funksion pas testimit; 3. Ueb faqet e komunave janë zhvilluar dhe është bërë migrimi i shënimeve tashme janë funksionale pritet të zëvendësohen në fillim të tetorit me ueb faqet aktuale, ueb faqet e MAPL-së është dizajnuar dhe janë në fazën e testimit pritet të vihet në funksion në fillim të muajit tetor dhe të bëhet migrimi i shënimeve; 4.

Teleprezenca është dizajnuar nga kompania implementuese pritet të vihet në funksion së bashku me ueb faqet e komunave; 5. Sistemi i Performancës është dizajnuar dhe është vërë në funksion dhe është në proces të testimit dhe migrimit të shënimeve. Ky projekt do të lansohet me një ceremoni në bashkëpunim me të gjithë akterët.

Kurse, me qëllim të avancimit të sistemit të monitorimit dhe raportimit të zbatimit të planit të punës së MAPL-së si dhe krijimit të një sistemi efikas të menaxhimit të të dhënave, është hartuar projekti për krijimin e platformës së integruar për menaxhimin e të dhënave të MAPL-së gjatë procesit të monitorit dhe raportimit. Në këtë drejtim janë hartuar specifikat për tenderimin e këtij sistemi. Është kontraktuar një kompani profesionale për programimin e Platformës së Monitorimit dhe Raportimit, sistem ky që përmbledh gjithsej 5 module specifike me disa nënndarje, duke përfshirë:

- Modulin për raportim të zbatimit të Planeve të Punës së MAPL-së;
- Modulin për raportim javor të njësive të MAPL-së;
- Modulin për vlerësimin e ligjshmërisë së akteve komunale;
- Modulin për përcjelljen e zbatimit të rekomandimeve të auditorit;
- Modulin për monitorimin dhe raportimin e mbledhjeve të kuvendeve të komunave dhe komiteteve obligative, raportimeve të kryetarit të komunës, publikimit të akteve; tubimeve publike me qytetarë dhe takimeve të këshillave komunale për siguri në bashkësi.

Përmes këtij sistemi të integruar do të grumbullohen të dhëna kualitative dhe kuantitative sipas një sistemi të treguesve për matje të performancës së punës brenda MAPL-së dhe performancës së organeve komunale, në mënyrë specifike Kuvendeve të Komunave. Sistemi do të përmirësoj procesin e menaxhimit të informatave, do të ndikoj në përmirësimin e punës së organeve komunave, përmbushjen e detyrimeve ligjore, arritjen më të lehtë të objektivave ministrisë, si dhe ofrimin e mbështetjes për komunat në zgjidhjen e problemeve të identifikuara në kuadër të fushave përkatëse. Kurse, në koordinim me menaxherin e projektit, janë dhënë të gjitha informatat e nevojshme të kërkuara nga kjo kompani lidhur me implementimin e platformës së raportimit. Në vazhdimësi janë zhvilluar takime të ndryshme me kompaninë *data prognat* me qëllim të finalizimit dhe dizajnit të platformës elektronike për raportim. Është finalizuar sistemi i platformës elektronike të raportimit së bashku me 5 module dhe është mbajtur një trajnim informues me stafin e MAPL-së nga kompania e cila do të menaxhon këtë platformë. Nga muaji janar i vitit 2018 pritet që platforma të funksionalizohet dhe të jetë e qasshme për të vepruar.

Qasja në dokumentet publike

Në ueb-faqen e MAPL-së janë publikuar 399 dokumente dhe informata, prej të cilave: 109 lajme dhe ngjarje, 136 shkresa të vlerësimit të ligjshmërisë, 6 raporte vjetore për vitin 2017, 1 raport vjetor për vitin 2016, 31 njoftime për vende të lira pune, 7 dokumente të prokurimit publik dhe 20 thirrje për propozime. 2 dokumente të projektligjit dhe akteve nënligjore për konsultim publik, 1 dokument - rregullore komunale, Ftesa /njoftime 2 dokument, Biografia e ministrit dhe 1 Analizë për investimet kapitale në komuna. Përveç tyre, në media janë dërguar 29 njoftime, si dhe janë trajtuar 48 pyetjet dhe janë kthyer 48 përgjigje tek parashtruesit e kërkesës për pyetje. Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe janë pranuar 12 kërkesa për qasje në dokumente publike, për të cilat përgjigjet janë kthyer në afat ligjor.

Është e verifikuar lista e personave kontaktues për qasje në dokumente publike në komuna për vitin 2017 dhe është bërë përmbledhja e listës nga komunat për emërtimet e pozitave që janë të emëruar zyrtarët e informimit në komuna, me kërkesë të zyrës për media me publikun brenda ZKM -s është kërkuar nga komunat për të raportuar për periudhën 1 shtator 2016 deri me 30 shtator 2017 ku deri me sot kanë raportuar 28 komuna për raportin për qasje në dokumente publike. Mbi bazën e kësaj, me qëllim të forcimit të zbatimit të ligjit për qasje në dokumentet publike dhe krijimit të mekanizmave lokal konform nenit 5 të ligjit në fuqi për qasje në dokumentet publike, MAPL ka adresuar shkresë zyrtare në Komunën e Zubin Potokut dhe Zveçanit për të kërkuar caktimin e zyrtarëve përgjegjës për qasje në dokumentet publike si dhe raportimin e rregullt tre-mujor për zbatimin e ligjit për qasje në dokumentet publike.

- Është organizuar takimi nga zyra e informimit pranë ZKM në mbështetje të MAPL dhe OSBE-së, është hartuar raporti i monitorimit të ueb faqeve komunale, por nuk është promovuar si publikim.
- Është realizuar vizita studimore në Mal të Zi për grupin punues ndërmintor për hartimin e KD-së për shërbimin e komunikimit qeveritar për të marrë praktikat në fushën e komunikimi publik;
- Është mbajtur një takim i grupit punues ndërmintor për të finalizuar koncept dokumentin e shërbimit qeveritar me qëllim të procedimit të mëtejshëm në procesin e konsultimit publik;
- Janë mbajtur 2 takime me Zyrën për Komunikim Publik pranë ZKM-së;

399

informata të publikuara, prej të cilave:

109 lajme dhe ngjarje;

136 shkresa të vlerësimit të ligjshmërisë;

6 raporte vjetore për vitin 2017,

1 raport vjetor për vitin 2016;

31 njoftime për vende të lira pune;

7 dokumente të prokurimit publik;

20 thirrje për propozime;

29 njoftime për media.

12 kërkesa për qasje në dokumente publike

48 përgjigje nga gjithsej 48 pyetje janë kthyer tek parashtruesit.

- Në bashkëpunim me OSBE-në, janë mbajtur 2 punëtori në rajonin e Prizrenit për Rolin e qeverisjes dhe transparencës lokale;
- Është mbajtur trajnimi mbajtur trajnimi nga kompania CACTTUS për zyrtarët për komunikim të MAPL-së për përdorimin e ueb-faqe së ri - modeluar të Ministrisë. Kurse, në bashkëpunim me AKK-në, projektin DEMOS dhe kompaninë Cacttus, është duke u përgatitur koncepti medial i lansimit të projektit IT dhe solucione për komunat, si dhe është mbajtur trajnimi 3 ditor për Zyrtarët e IT-së së Komunave dhe Zyrtarët të Informimit të Komunave për përdorimin e ueb-faqe së ri - modeluar të Ministrisë.

Gjithashtu, gjatë periudhës janar – dhjetor, 2017 janë mbajtur 4 takime me partnerët dhe donatorët me qëllim të koordinimit dhe përmbylljes së projektit IT dhe solucione për Komuna, ka vazhduar procesi i editimit dhe migrimit të të dhënave dhe informatave nga ueb faqja e vjetër në ueb faqen e re dhe aktualisht është në fazën finale funksionalizimi i ueb - faqet e ri-modeluara të komunave. Për këtë qëllim, MAPL ka mbajtur 1 takim me komunat, OJQ-të dhe mediat me qëllim të prezantimit të ueb faqeve të ri-modeluara të komunave. Gjatë vitit 2017, janë mbajtur 3 takime të grupit punues ndërmintor për KD për shërbimin e komunikimit qeveritar. Koncept Dokumenti ka kaluar në platformën e konsultimit publike duke i përmbyllur të gjitha fazat dhe i njëjti është miratuar nga Qeveria në muajin dhjetor 2017.

MAPL ka dhënë kontribut edhe në finalizimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit Kundër korrupsion 2018-2022, pastaj në hartimin e Koncept Dokumentit për fushën e turizmit i organizuar nga MTI dhe misioni i ekspertëve të programit TAIEK, është hartuar plani i brendshëm i komunikimit për MAPL, është mbajtur takimi 1 ditor me zyrtar për informim të komunave lidhur me transparencën lokale, si dhe është përgatitur raporti për zbatimin e Strategjisë Kombëtare për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit që shpie në terrorizëm. I njëjti është proceduar tek Sekretariati i Këshillit të Sigurisë së Kosovës. Në proces e sipërm janë: hartimi i fletës informuese që do të përgatitet pas hartimit dhe finalizimit të Raportit Vjetor të MAPL-së 2017, bultetini vjetor i MAPL –së për vitin 2017 dhe platforma on-line për transparencë financiare e cila parashihet të lansohet në 6 muajin e parë të vitit 2018. Po ashtu, me qëllim të rritjes së transparencës komunale janë ndërmarrë aktivitetet si në vijim:

- Monitorimi i publikimit të rregulloreve dhe vendimeve në ueb-faqet zyrtare të komunave dhe hartimi i raporteve përkatëse në baza periodike;
- Monitorimi i publikimit të njoftimeve për mbledhjet e kuvendeve të komunave, njoftimeve për debatet publike me qytetarë, publikimi i procesverbale, buxheteve komunale dhe publikimi i dokumenteve në gjuhët zyrtare;
- Monitorimi i publikimit të vendimeve të kryetarëve të komunave;
- Monitorimi i transparencës në prokurim;
- Monitorimi i zbatimit të Planeve të Veprimit për transparencë dhe prezantimi i tij;
- Është hartuar dhe botuar fletushka “*Bëhu pjesë e vendimmarrjes në komunën tuaj*” me qëllim të rritjes së pjesëmarrjes së qytetareve në vendimmarrje;
- Janë finalizuar raportet periodike lidhur me qasjen në dokumente publike (K1 – K4, 2017), si dhe raportet për publikimin e buxhetit të komunave dhe raportet për publikimin dokumenteve në gjuhë zyrtare;

- Në vazhdimësi janë mbajtur takime për zhvillimin e aktiviteteve me shoqërinë civile lidhur me monitorimin e transparencës në komuna (KDI, INPO, FOL, EC MA NDRYSHE);

Krahas tyre, gjatë kësaj periudhe është bërë vlerësimi i Planit të veprimit për transparencë të cilat i kanë dërguar komunat dhe është hartuar raportit i transparencës së komunave, është dërguar raporti i transparencës për periudhën janar - qershor 2017, të komunat për komente kur vetëm 7 komuna kanë dhënë komente lidhur me të dhënat e përfshira në raport. Pastaj, gjatë muajit tetor, 2017 është mbajtur takimi me zyrtarë komunal, ku është bërë prezantimi i raportit për transparencën e ueb faqeve të komunave. Më tej gjatë periudhës 1 vjeçare, MAPL ka përfunduar edhe këto aktivitete:

- Është finalizuar dizajni i ri i ueb faqes së re të MAPL-së. Në javën e parë të muajit tetor parashihet të bëhet migrimi i të dhënave dhe mbajtja e trajnimit për stafin e divizionit për komunikim publik;
- Është organizuar takim me zyrtarë komunal për planin e veprimit për transparencë me 18 dhe 20 korrik 2017;
- Pjesëmarrje në takimet e organizuar nga shoqëria civile dhe prezantimi i transparencës për komuna;
- Është shqyrtuar Udhëzimi Administrativ MAPL Nr. 02/2014 MAPL për caktimin e stafit mbështetës në komuna dhe Rregullores NR. 03/2011 për shërbimin e komunikimit qeveritar me publikun;
- Koncept Dokumenti për Zhvillim Rajonal ka kaluar në procesin e diskutimit publik në platformën on-line të konsultimit publik dhe në ueb faqen zyrtare të MAPL-së për komente.

Bazuar në planin e punës të MAPL-së, me qëllim të promovimit të politikave që stimulojnë demokracinë direkte dhe përfshirjen e qytetarëve, ka filluar mbledhja e të dhënave për hartimin e Manualit për përfshirje të qytetarëve në punë vullnetare, një draft i cili ka përfunduar.

Objektivi 4

Forcimi i kapaciteteve profesionale dhe institucionale të komunave për të përmbushur kërkesat e qytetarëve dhe për të arritur përmirësim të qëndrueshëm në shërbimet komunale

Aktivitetet e realizuara për zbatimin e objektivit 4 të Planit të Punës për vitin 2017, janë grupuar në 3 fusha kryesore:

- Ngritja e kapaciteteve të zyrtarëve komunal;
- Të drejtat e njeriut;
- Bashkëpunimi me shoqërinë civile.

Indeksi i arritjeve në objektivin 4

- 4 projekte të mbështetura për trajnimin e zyrtarëve komunal nga donatorë;
- 2 projekte të aprovuara nga TAIEX/KE;
- 59 Trajnime të organizuara;
- 1787 zyrtarë komunal;
- 2 broshura informative për komunat të hartuara;
- 5 dokumente/raporte të hartuara në fushën e kapaciteteve;
- 16 komuna të monitoruara në zbatimin e legjislacionit për të drejtat e njeriut;
- Përfshirja në 6 grupe punuese për politikën në fushën e të drejtave të njeriut;
- 46 projekte të financuara për OJQ-të në vlerë 173,326.00 euro.

Ngritja e kapaciteteve të zyrtarëve komunal

Mbështetja e komunave në fushën e ngritjes së kapaciteteve profesionale është bërë përmes trajnimeve të organizuara. Sipas planit të trajnimeve të përgatitur për vitin 2017 janë organizuar një numër i konsiderueshëm i trajnimeve për zyrtarët komunal. Në bashkëpunim me UNDP-në është bërë vlerësimi i nevojave për ngritje të kapaciteteve për zyrtarët komunal. Për të siguruar mbështetje financiare për organizimin e trajnimeve, janë mbajtur edhe takime individuale me donatorët: USAID/AKT, OSBE, UNDP, nga të cilët është siguruar mbështetje në organizimin e 3 projekteve për trajnimin e zyrtarëve komunal, përfshirë: kryesuesit e kuvendeve të komunave, anëtarët e kuvendeve të komunave, zyrtarët ligjor dhe zyrtarët për integrime evropiane në komuna. Veç kësaj, janë përgatitur 2 broshura informative për komunat, të cilat janë publikuar në faqen zyrtare elektronike të MAPL-së, si dhe Informatori “10 ide të shkëlqyeshme për trajnimet on-line” për përfitimet e përgjithshme nga trajnimet. Është kontraktuar kompania UBO Consulting dhe një ekspert për përfundimin e vlerësimit të nevojave për ngritje të kapaciteteve. MAPL e ka rolin e monitoruesit të përfundimit të punës.

Trajnimet e organizuara

Sa i përket numrit të trajnimeve të organizuara dhe përfituesve nga këto trajnime, gjatë periudhës janar-dhjetor 2017, në total janë organizuar 59 trajnime dhe janë trajnuar 1787 zyrtarë komunal.

Pjesa më e madhe e trajnimeve janë organizuar në bashkëpunim me IKAP-in. Gjithashtu, në bashkëpunim me projektin DEMOS/Helvetas dhe Asociacionin e Komunave është mbajtur trajnimi me zyrtarët komunal për integritet evropian dhe janë trajnuar 23 zyrtarë. MAPL konform aplikimit në Komisionin Evropian përkatësisht instrumentin TAIEX ka fituar 2 projekte për trajnime, nga të cilat kanë përfituar dy grupet punuese të MAPL-së për hartim të koncept-dokumenteve. Në vijim është paraqitur figura me të dhënat për trajnime:



Figura 5: Organizimi i trajnimeve gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2017.

Lidhur me forcimin e kapaciteteve profesionale dhe institucionale të komunave për të përmbushur kërkesat e qytetarëve dhe për të arritur përmirësim të qëndrueshëm në shërbimet komunale, ka realizuar këto aktivitete, si vijon:

- Plani i trajnimeve për vitin 2017;
- Raporti i vlerësimit të kapaciteteve profesionale të zyrtarëve komunal i përfunduar në 38 komuna;
- Në bashkëpunim me UNDP-në është bërë vlerësimi i nevojave për ngritje të kapaciteteve për zyrtarët komunal;

- Për fushën e ngritjes së kapaciteteve, janë përgatitë 2 broshura informative për komunat të publikuara në faqen zyrtare elektronike të MAPL-së. Veç kësaj është përgatitur një informator për përfitimet e përgjithshëm nga trajnimet “10 ide të shkëlqyeshme për trajnimet on-line”;
- Është finalizuar analiza për mbajtjen e trajnimeve në komuna.

Aktivitetet në fushën e të drejtave të njeriut

Gjatë periudhës raportuese, MAPL në kuadër të planit të integruar të monitorimit ka inkorporuar edhe pyetësorin në fushën e të drejtave të njeriut. Sipas këtij plani, janë mbledhur të dhënat për masat e ndërmarra nga komunat në fushën e të drejtave të njeriut dhe janë hartuar raportet vetëm për 16 komunat e monitoruara. Në kuadër të këtyre vizitave, zyrtarët komunal për të drejtat e njeriut janë njoftuar për pakon e re të ligjeve për të drejtat e njeriut. MAPL ka dërguar në komuna shkresë përcjellëse për të kërkuar nga kryetarët e komunave caktimin e zyrtarëve përgjegjës për mbrojtje nga diskriminimi dhe konform kësaj, komunat: Drenas, Vushtrri, Graçanicë, Ferizaj dhe Deçan, kanë emëruar zyrtarët përgjegjës të kërkuar.

16

Komuna janë monitoruar për shkallën e zbatimit të pakos ligjore për të drejtat e njeriut, për të cilat janë hartuar raportet individuale.

Krahas monitorimit të kësaj fushe, MAPL ka shtrirë aktivitetet edhe në kuadër të grupet punuese ndërministrorë për qëllim të promovimit të të drejtave të njeriut. Gjatë kësaj periudhe, MAPL ka qenë e përfshirë në këto grupe punuese:

- Grupi punues për të drejtat e fëmijëve - është organizuar një punëtori për hartimin e strategjisë për të drejtat e fëmijëve;
- Grupi Punues për parandalimin e punëve të rënda të fëmijëve - në 16 komuna në MPMS, MZHBR, MPB, MKRS është shpërndarë fletëpalosja për parandalimin e punëve të rënda të fëmijëve me moton “*ndal punën e fëmijëve*” dhe fletëpalosja (përmbledhja e konventës për të drejtat e fëmijëve me moton, të drejtat e tua, përmbledhje e shkurtër nga konventa për të drejtat e fëmijëve të cilat u financuan dhe mbështetën nga UNICEF-i;
- Grupi Punues për të drejtat e komunitetit LGBTI;
- Rrjeti për politika të gjuhës me Zyrën e Komisionit të Gjuhëve;
- Grupi Punues për parandalimin e trafikimit të njerëzve
- Grupi Punues për përfshirjen në shoqërinë kosovare të komuniteteve rom dhe ashkali;
- Grupin Punues për hartimin e Strategjisë për bashkëpunim me shoqërinë civile.

Në vazhden e aktiviteteve janë mbajtur takime me zyrtarët e ministrive të linjës për barazi gjinore, për shkëmbimin e përvojave dhe koordinimin e aktiviteteve për rritjen e barazisë gjinore në punësim dhe vendimmarrje dhe janë mbledhur të dhënat nga komunat për pozitën vendimmarrëse dhe është hartuar raporti lidhur me këtë. Takimet me ministritë e linjës janë mbajtur edhe sa i përket ligjit për mbrojtje nga diskriminimi, është caktuar zyrtarja për mbrojtje nga diskriminimi në MAPL. Gjithashtu, ka filluar procesi i mbledhjes së të dhënave për hartimin e raportit për zbatimin e ligjit për barazi gjinore. Janë njoftuar të gjitha komunat për Rregulloren e re për mekanizmat institucional për mbrojtjen nga diskriminimi, si dhe

është hartuar projekt propozimi për trajnimin me temën *“Të drejtat e personave të riatdhesuar dhe të kthyer nga vendet e treta”*. Aktivitete të tjera të zhvilluara në fushën e të drejtave të njeriut janë:

- Mbledhja e të dhënave dhe inkorporimi në raportin vjetor të komunave të Kosovës (2016);
- Koordinimi i aktiviteteve me ministritë e linjës, ZQM/ZKM dhe komunat për përgjegjësitë e komunave për zbatimin e Strategjisë për Personat me Aftësi të Kufizuar, me ç’rast janë mbajtur dy takime me komunën e Drenasit. 14 komuna kanë hartuar planin lokal të veprimit për PAK. Këto takime janë zhvilluar në kuadër të projektit SoRi. Po ashtu, përmes projektit SoRi është mbajtur trajnimi 3 ditor në Shkup me temën *“Aplikimi i fondit IPA II”*, si dhe janë mbajtur takime koordinuese me GIZ-in lidhur me realizimin e trajnimeve për të drejtat sociale për zyrtarët e komunave të përfshira në projektin SoRi (Prishtina, Prizreni, Gjilani, Drenasi, Ferizaj dhe Mitrovicës Jugore) pjesa e parë dhe e dytë.
- Është bërë monitorimi i zbatimi të ligjit për përdorimin e gjuhëve në komuna.
- Është dhënë mbështetje për 7 komuna në hartimin e planeve lokale për përfshirjen e komuniteteve RAE në shoqërinë kosovare.
- Është mbajtur takimi me përfaqësuesen e UNICEF-it lidhur me fëmijët me nevoja të veçanta;
- Janë zhvilluar takime të shumta në parapërgatitjet e fushatës kundër trafikimit me njerëz. Hapja e konferencës *“Konferencë me rastin e shënimit Ditës së BE-së kundër Trafikimit me njerëz”*.
- Është plotësuar pyetëtori i TIP Raportit të Departamentit të Shtetit Amerikan në lidhje me trafikimin e qenieve njerëzore.
- Është përcjell në të gjitha komunat e Republikës së Kosovës Strategjia dhe Plani i veprimit për përfshirjen e komuniteteve rom dhe ashkali në shoqërinë kosovare 2017-2021, pastaj letra drejtuar komunave për krijimin e një mekanizmi të ri i cili ka përgjegjësi monitorimin, koordinimin dhe zbatimin e Strategjisë për përfshirjen e komuniteteve rom dhe ashkali në shoqërinë kosovare, 2017-2021.
- Është përcjell Rregullorja e re për Mekanizmat Institucional për mbrojtje nga Diskriminimi në të gjitha komunat e Kosovës;
- Janë mbajtur dy takime me departamentet e MAPL-s për buxhetimin gjinor dhe është hartuar raporti i cili është dërguar në ZKM.
- Janë monitoruar komunat lidhur me zbatimin e ligjit për barazi gjinore dhe janë hartuar raportet;
- Janë zhvilluar takime të rregullta në mes të MMPH-së, MD-së, MZHE-së, MAP-it dhe MAPL-së, lidhur me barazinë gjinore, për shkëmbimin e përvojave dhe koordinimin e aktiviteteve në zbatimin e politikave në punësim dhe vendimmarrje.
- Takime të rregullta me Grupin Ndërmnistrorë kundër trafikimit me qenie njerëzore.
- Është përgatitur broshura kundër trafikimit me qenie njerëzore, si dhe për këtë qëllim është mbajtur fushatë vetëdijesuese në të gjitha komunat e Republikës së Kosovës.
- MAPL ka qenë pjesë e hartimit të Strategjisë Nacionale për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Plani i Veprimit 2016-2020.
- Në përputhje me rekomandimet dhe kërkesat e Avokatit të Popullit, është përgatitur raporti i cili adreson obligimet e komunave për respektimin e legjislacionit për barazi gjinore.

- MAPL ka qenë pjesë e grupit për shqyrtimin e Rregullores mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OSHC-ve si dhe Planit të punës për vitin 2017.
- Është hartuar analiza ligjore dhe propozimet e opsioneve për standardet minimale për konsultim me publikun në nivelin lokal, raporti vjetor për personat me aftësi të kufizuar dhe raporti për të drejtat e minitoriteve.

Projektet e financuara për OJQ

46

projekte të komunave të
financuara për OJQ, në vlerën prej
173,326.00 euro.

Bashkëpunimi me shoqërinë civile

Në lidhje me bashkëpunimin me shoqërinë civile, MAPL gjatë kësaj periudhe (janar – dhjetor, 2017) i ka kushtuar rëndësi të veçantë mbështetjes së organizatave joqeveritare përmes financimit të projekteve të tyre. Fillimisht, me datën 20 Janar 2017, MAPL ka shpallur thirrjen për projekt-propozime me qëllim të mbështetjes financiare të komunave, institucioneve të tjera dhe organizatave të shoqërisë civile. Financimi i projekteve është bërë me qëllim të avancimit të vetëqeverisjes lokale, fuqizimit të partneritetit dhe rolit të shoqërisë civile në qeverisjen lokale, si dhe zbatimit të objektivave të Strategjisë për Vetëqeverisje Lokale 2016-2026. Njëkohësisht me thirrjen për propozime, është themeluar komisioni *ad hoc* për vlerësimin e projekteve të propozuara. Në këtë fazë, janë mbështetur financiarisht 46 projekte, prej të cilave 42 OJQ, 2 projekte për komuna dhe 2 projekte për institucione të tjera të administratës publike. Vlera totale për financimin e 31 projekteve kap shumën prej 127,326.00 euro. MAPL ka zotuar mjetet për 30 projekte të organizatave joqeveritare të cilave u janë aprovuar projektet e tyre nga komisioni vlerësues. Vlera e mjeteve të zotuar në këtë periudhë është 82,870.00 euro. Pjesa më e madhe e projekteve kanë filluar të zbatohen, ndërsa monitorimi i ecurisë është bërë përmes zyrtarëve përgjegjës për monitorimin e zbatimit tyre.

Në kuadër të aktiviteteve, MAPL ka marrë pjesë në takimin informues të organizuar nga MIE dhe GIZ me temë “Përfshirja e OSHC-ve dhe palëve të tjera të interesuara në kuadër të strukturave të MSA-së”.

Administrata dhe financat

Gjatë periudhës Janar-dhjetor 2017, është bërë dorëzimi i Kesh-Planit të parë në Ministri të Financave, është hapur petty cash-i, janë mbledhur të dhënat lidhur me pasqyrat financiare, janë regjistruar pasuritë dhe stoqet për vitin 2016. MAPL ka përgatitur të gjitha fletet alokimet për Ministrinë e Financave, pastaj

janë kompletuar lëndët (gjashtë pako) për MeM dhe PIP, si dhe është bërë alokimi i mjeteve për 52 projekte për vitin 2017. Gjithashtu, me qëllim të bashkëpunimit sa më të mirë me ZKA dhe departamentet tjera të MAPL-së është bërë identifikimi i nevojave buxhetore lidhur me rishikimin e buxhetit po ashtu edhe për qarkoren e parë buxhetore.

Në gjashtëmuorin e parë të vitit 2017, MAPL gjithashtu ka dorëzuar në Ministrinë e Financave KASH-in për periudhën 2018-2020, i cili është aprovuar në Qeveri, janë paraqitur në KASH dhe në Qarkoren e parë Buxhetore 2018-2020 përcaktimi i nevojave për financim si dhe përcaktimi i projekteve kapitale dhe kategorive tjera ekonomike si: Paga, Mallra dhe Shërbime për financim në periudhën e ardhshme trevjeçare. Janë hartuar planet me qarkoren e parë buxhetore lidhur me hartimin e Planit për Investime Publike PIP, pastaj është bërë përgatitja e kërkesës buxhetore dhe është dorëzuar me 15 Qershor 2017 në MF, si dhe janë planifikuar mjetet për periudhën 2018-2020 dhe janë vendosur në sistemin e Free-Balancit – BDMS, janë mbajtur dëgjimet e para buxhetore. Ministria e Financave na ka njoftuar që të bëjmë rishikimin e buxhetit për vitin 2017 ku në këtë rishikim janë paraqitur kërkesat e MAPL-së për ndryshimet në kategori ekonomike, (zvogëlim dhe rritje nëpër kategori, kursime në kapitale). Kurse, bazuar në Qarkoren buxhetore 2018/01 në të cilën janë përfshi kufijtë fillestar për buxhetin e vitit 2018 me date 05.10.2017 e kemi dorëzuar kërkesën buxhetore të rishikuar.

Ka vazhduar procesi i analizimit të ecurisë së shpenzimeve në periudhën e parë të vitit 2017, i cili është bërë në baza mujore dhe sipas nevojave. Lidhur me aspektet e menaxhimit financiar dhe kontrollit siç janë: delegimi i autorizimeve për shpenzime, lista e rreziqeve etj. Me datë 28 shkurt është dorëzuar Lista vetë vlerësuese në MF. Ndërsa, lista e rreziqeve është finalizuar me 24 prill 2017. Me datë 25 maj 2017, janë kërkuar mjete shtesë me qarkoren e parë buxhetore. Sa i përket pranimit të kërkesave iniciuese për zotimin e mjeteve në SIMFK, përgatitja e formularit për Urdhër Obligim dhe Pagesë, regjistrimi i zotimeve në SIMFK dhe regjistrimi i shpenzimeve në SIMFK janë procese që kryhen në vazhdimësi gjatë tërë vitit.

*Totali i shpenzimeve
për buxhetin e MAPL-
së është 4,196,207.36
EUR ose 84.91 %,
ndërsa prej kategorisë
se donacionit
103,611.01 EUR ose
58.00 %*

Është analizuar dhe harmonizuar me raportet e brendshme barazimi i regjistrimit të shpenzimeve me Departamentin e Thesarit në MF që përfshinë kontrollimin e raportit të SIMFK për periudhën janar-shtator, kurse periudha janar- dhjetor 2017 do të dorëzohet në muajin janar 2018. Në vazhdimësi është bërë hapja dhe mbyllja e Avanseve për udhëtime zyrtare, si dhe hapja, rimbushja që përfshinë tërheqjen e parave të gatshme nga banka komerciale dhe kthimi i mjeteve në rastet kur ka kthim të mjeteve gjatë kësaj periudhe. Po ashtu, në baza mujore është bërë regjistrimi i të gjitha transaksioneve për të gjitha kategoritë ekonomike dhe krahasimi i tyre me raportet e Freebalance. Sa i përket menaxhimit të pasurisë së MAPL-së ka filluar regjistrimi i pasurisë mbi 1,000.00 €, në SIMFK, si dhe Regjistrimi i pasurisë në sistemin e-pasuria nën 1,000.00 €. Totali i shpenzimeve 12 mujore për buxhetin e MAPL-së është në vlerën prej 4,196,207.36 EUR ose 84.91 %, ndërsa prej kategorisë se donacionit është shpenzuar shuma prej 103,611.01 EUR ose 58.00 %.

Administrata në kuadër të MAPL ka qenë funksionale dhe në shërbim të institucionit të MAPL-së. Gjatë vitit 2017 është ofruar ndihma në përkthim të materialeve, dokumenteve të ndryshme në gjuhën serbe dhe angleze, ka pasur në vazhdimësi lektorime të dokumenteve në gjuhë zyrtare, janë ofruar përkthim simulant në takime të ndryshme të cilat kanë i kanë zhvilluar njësitë e MAPL-së. Pastaj, janë ofruar shërbime në transport, shpërndarje të materialeve të ndryshme, fotokopje, janë ndihmuar komunat dhe stafi i MAPL-së përmes help-deskut, si dhe shërbime të tjera. Sipas të dhënave në periudhën Janar – Dhjetor, 2017 MAPL ka këtë strukturë të shërbyesve civil: 130 shërbyes civil, 60 femra, 7 meshkuj. Sa i përket përbërjes etnike ato janë: 99 shqiptar 29 serb 2 turq.

MAPL, ka filluar zbatimin e planit të personelit për vitin 2017, janë iniciuar në vazhdimësi kërkesat për rekrutimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve për pozita të lira, janë kompletuar dosjet lidhur me kërkesat inicuese për procedurat e rekrutimit për pozitat e lira në MAPL, si dhe është bërë njoftimi në faqen zyrtare të MAPL-së për përzgjedhjen e kandidatëve të suksesshëm. Në vazhdimësi përditësohet baza elektronike me të dhëna për stafin e MAPL-së, po ashtu bëhet menaxhimi i udhëtimeve zyrtare, si dhe inventarizimi i dosjeve personale. MAPL koordinon aktivitetet me IKAP-in sa i përket fushës së trajnime, gjithashtu ka koordinim edhe me Agjensionin Anti Korrupsion për sa i përket deklaramit të pasurisë.

Auditimi i brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB) për periudhën kohore janar - dhjetor /2017 në përputhje me Planin vjetor 2017, ka kryer këto aktivitete:

- NjAB-i gjatë muajit janar 2017 ka përmbyllur punën e vitit 2016 duke hartuar dhe proceduar tek menaxhmenti i lartë i MAPL-së dhe Njesisë Qendrore të Auditimit të Brendshëm/Ministria e Financave (NJQH/AB-MF), Raportin e tremujorit të katërt (K4/2016) dhe Raportin vjetor për vitin 2016;
- Janë hartuar raportet periodike K1, K2 dhe K3 për vitin 2017 për punën e NJAB-it dhe proceduar tek menaxhmenti i lartë i MAPL-së dhe NJQH/AB-MF;
- Në këtë periudhë kohore janë kryer dhe proceduar raportet finale auditimet si: “ Vlerësimi i adresimit dhe zbatimi i rekomandimeve të dala nga auditimet e përfunduara në vitin 2016”, “Sistemi i menaxhimit të buxhetit të MAPL-së –faza e I-rë”, “Sistemi i menaxhimit të prokurimit”, “Menaxhimi i pasurive në MAPL” dhe “Menaxhimi i burimeve njerëzore në MAPL”, “Sistemi i menaxhimit të buxhetit në MAPL-faza II-të” dhe “Menaxhimi i investimeve kapitale-PIP-ve”.
- NJAB-i, ka hartuar Planin Strategjik 2018-2020 dhe Planin Vjetor për vitin 2018 të NJAB-së dhe pas aprovimit/ miratimit nga Sekretarja e Përgjithshme, KAB-i dhe Ministri e ka proceduar edhe në Njësinë Qendrore të Auditimit të Brendshëm / Ministria e Financave në afatin ligjor - 31.10.2017 dhe
- Në vazhdimësi sipas kërkesave, ka ofruar shërbime këshilluese për Sekretaren e Përgjithshme dhe të tjerët.

Komiteti i Auditimit të Brendshëm në MAPL për periudhën janar – dhjetor/2017 ka mbajtur IV-të takime të rregullta me NjAB-in dhe menaxhmentin e lartë (Sekretaren e Përgjithshme) të MAPL-së.

Prokurimi

Gjatë periudhës janar-dhjetor, 2017 edhe njësia e prokurimit ka zhvilluar aktivitet e saj të planifikuara. Në këtë drejtim janë zhvilluar kontrata publike për furnizimet dhe shërbimet e prokurimit, të cilat janë pasqyruar në raportin tremujor të njësisë përkatëse. Prej 16 aktiviteteve të prokurimit, 4 janë tender, 7 kuotime çmimesh, 1 kuotim çmimesh i anuluar, 1 kuotim çmimesh i rishpallur dhe 5 blerje minimale.